

jalor i shprehjeve lidhur me diskriminimin



FJALOR I SHPREHJEVE
LIDHUR ME
DISKRIMINIMIN

Shkup, 2008

- **Botues**
Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar
- **Për botuesin**
Sasho Klekovski
Drejtor ekzekutiv
- **Autorë**
Prof. Dr. Mirjana Najçevska
Mr. Bekim Kadriu
- **Ekipi i projektit**
Emina Nuredinoska
- **Dizajni**
Koma lab.
- **Shtypi**
Borografika
- **Tirazhi 300**

CIP – Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“,
Скопје

316.647.82 (038)

342.724 (038)8

NAJÇEVSKA, Mirjana

Fjalori i shprehjeve lidhur me diskriminimin / (Mirjana Najçevska,
Bekim Kadriu). – Shkup : Qendra Maqedonase për Bashkëpunim
Ndërkombëtar, 2008. – 112 str. ; 14 cm

ISBN 978-9989-102-73-8

1. Kadriu, Bekim (avtor)

a) Diskriminacija – Leksikoni

COBISS.MK – ID 74316810

Qëllimi i këtij fjalori të termeve lidhur me diskriminimin është përdorimi më i lehtë i ligjit kundër diskriminimit



osce

Organization for Security and Co-operation in Europe

Spillover Monitor

Mission to Skopje

Fjalori i shprehjeve është tekst autorësh, qëndrimet dhe mendimet e shprehura në atë nuk i reflekton qëndrimet dhe mendimet e QMBN.

Përmbajtja e këtij botimi jo gjithnjë i shpreh pikëpamjet ose qëndrimet e Misionit vëzhgues të OSBE në Shkup.




Qëllimi i këtij fjalore të termeve lidhur me diskriminimin është përdorimi më i lehtë i Ligjit kundër diskriminimit dhe unifikim të termeve të cilat përdoren në komunikimin e përditshëm lidhur me diskriminimin.

Fjalori u dedikohet të gjithë atyre që e përdorin Ligjin kundër diskriminimit në praktikë (persona individual, organe gjyqësore, avokatë, zyra e Avokatit të popullit, nëpunës shtetëror, shoqata të qytetarëve), si dhe për të gjithë ata që dëshirojnë të merren me këtë problematikë.

Termet dhe sqarimet para së gjithash bazohen në dokumentet themelore ndërkombëtare të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte merren me diskriminimin dhe ndalesën e diskriminimit (Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Qytetare dhe Politike, Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës nr. 111, Konventa e OKB për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe Neni 13 nga Direktiva Racore dhe Direktiva për Punësim dhe Profesione si Minimum Standarde të UE) si dhe definicionet e pranuar nga ana e organizatave ndërkombëtare dhe rajonale (OKB, Këshilli i Evropës, OSBE, UE) dhe organizata joqeveritare dhe akademike, të cilat merren me problematikën adekuate.

Nevoja nga unifikimi terminologjik mes tjerave rrjedh edhe nga fakti i ndikimit dominues, të cilin e ka tradita nacionale në luftën kundër diskriminimit, që nënkupton edhe individualizimin e termeve që përdoren (e në pajtim me kuptimet më gjerë të pranuar në planin ndërkombëtar).

Identifikimi i drejt i diskriminimit ka rëndësi të madhe për aplikimin e mekanizmave më adekuate për mbrojtje, mes tjerash edhe në funksion të alarmimit të bashkësisë më të gjerë dhe përgatitjen e strategjive dhe politikave parandaluese. Në pajtim me këtë, mendojmë se ngritja e vetëdijes së qytetarëve për të drejtat e tyre përkundër praktikave të mundshme diskriminuese, si dhe për mekanizmat për mbrojtje me të cilat disponojnë, është e lidhur ngushtë me përcaktimin e saktë të disa kategorive, situatave dhe institucioneve.



Aktivitet për mbrojtjen nga diskriminimi
Arsimimi (si bazë për diskriminim)
Asimilimi (i dhunshëm)
Adaptim i arsyeshëm

■ Aktivitet për mbrojtjen nga diskriminimi

Çdo (ngritje) udhëheqje e procedurës administrative ose ankesës, si dhe dëshmia në procedurën për mbrojtjen nga diskriminimi.

Nënkupton çdo involvim aktiv në procedura të përcaktuara ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi (qoftë si subjekt me legjitimitet aktiv, qoftë si dëshmitar ose si vëzhgues-lajmërues), pavarësisht nga ajo nëse ato kanë qenë pjesë nga ndonjë procedurë tjetër gjyqësore, drejtuese-administrative ose ndonjë tjetër para ndonjë organi të definuar kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut (gjyqet e rregullta, zyra e Avokatit të popullit, Komisioni i përhershëm anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, organe të veçanta të formuara për mbrojtjen nga diskriminimi, komisione pranë ministrive, inspektorateve, strukturave drejtuese në institucionet publike dhe private).

7

■ Arsimimi (si bazë për diskriminim)

Shkalla (niveli) dhe lloji i arsimimit të një individi mund të paraqitet si bazë e diskriminimit në të gjitha marrëdhëniet ku arsimimi nuk paraqet bazë legjitime për të bërë dallime mes individëve.

Për shembull, praktikizmi i të drejtave dhe lirive mund të jetë i kufizuar për shkak të arsimimit të individit në raste kur informatat e nevojshme relevante për jetën e përditshme jepen në mënyrë joadekuate, që është i pakuptueshëm për personat me arsimim më të ulët.

Arsimimi si bazë e diskriminimit mund të manifestohet edhe në rastet kur përdoret si kriter për punësim ose ndonjë lloj tjetër i angazhimit në punë, e nuk paraqet kusht thelbësor, por punëdhënësi me qëllim e inkorporon që të përjashtojë kategori të caktuar të qytetarëve nga mundësia për të aplikuar. Kriteret e këtilla (të aplikuar në mënyrë neutrale) mund të iniciojnë çështjen e diskriminimit jo të drejtpërdrejtë.

Për shembull, kur për vende pune joprofesionale kërkohet si kusht-arsimimi, ose ndonjë shkallë tjetër e arsimit (arsimi fillor).

Lloj tjetër i diskriminimit në bazë të arsimit është refuzimi i Institucionit për punësim t'i regjistrojnë në listën e njerëzve të cilët kërkojnë punë e që janë të paarsimuar ose nuk kanë mbaruar arsim fillor.

■ Asimilimi (i dhunshëm)

Asimilimi i dhunshëm është proces i absorbimit të padëshiruar të bashkësive të ndryshme etnike dhe/ose kulturore në bashkësi dominante etnike dhe/ose kulturore me çka arrihet homogjenizim i bashkësisë më të gjerë në nivel nacional.

Asimilimi i dhunshëm shpesh shoqërohet me kolonizim dhe me shpërngulje të dhunshme.

Asimilimi i dhunshëm mund të përdoret me qëllim që të shtypen subkulturat, si akt i diskriminimit kundër pakicave ose si instrument politik me qëllim që të krijohet unitet nacional (shpesh me arsyetimin se në këtë mënyrë pamundësohen burimet e mundshme të aktiviteteve subversive).

Asimilimi i dhunshëm mund të realizohet nëpërmjet: dërgimi i njerëzve nga një grup i caktuar pakice që të punojnë larg vendbanimit të tyre, kufizimi i mundësive për arsimin në gjuhën e tyre, ndalesa dhe kufizime të manifestimit të lirë të identitetit të tyre (pamundësi e kultivimit të traditës së kulturës personale dhe/ose traditave religjioze), kufizime në vendosje/shpërngulje etj.

■ Adaptim i arsyeshëm

Një nga obligimet më të rëndësishme lidhur me invaliditetin është obligimi i adaptim i arsyeshëm. Kjo do të thotë ndryshim dhe dis-ejnim i nevojshëm i rrethinës, të cilat nuk paraqesin ngarkim disproporcional dhe të tepërt, me qëllim që personave me invaliditet

t'u sigurohet gëzimi dhe shfrytëzimi i të gjitha të drejtave dhe lirive të njeriut barabart me të tjerët.

Për shembull, obligimi për ndryshim për shkak të mundësisit pa pengesë të qasjes së personave me invaliditetet deri te objektet publike, adaptim të mjeteve për transport publik (me qëllim të qasjes së tyre për personat me invaliditet, për personat e moshuar dhe për foshnjat në karroca), disejtimi i tualeteve në institucionet publike të arritshme për personat me invaliditet, vendosja e ashensorëve në objektet publike, sinjalet me zë në udhëkryqe.

Adaptimi i arsyeshëm ka kuptim më të gjerë nga sigurimi i rrethimit adekuat infrastrukturor. Nën këtë term nënkuptohet edhe marrja e masave me të cilat personave me invaliditetet u mundësohet punësimi, gjegjësisht trajnimi adekuat. Në këtë kuptim, me këtë term nënkuptohen edhe: adaptimi i vendit të punës, redistribuimi i obligimeve mes anëtarëve të ekipit konkret etj.

B

Barazia
Barazi e rasteve (mundësive)
Bindja
Barrë e dëshmimit

■ Barazia

Parimi sipas të cilit të gjithë njerëzit janë të barabartë, gjegjësisht të barabartë në obligimet dhe të drejtat. Barazia nënkupton llojllojshmëri, gjegjësisht nënkupton ekzistimin e subjekteve të ndryshme të cilat duhet të trajtohen njëllëj.

Parimi i barazisë nënkupton:

- Barazia politike – parim sipas të cilit secili ka të drejtë të marrë pjesë në jetën politike (e drejta të merret pjesë në pushtet, të merret pjesë në procesin e vendimmarrjeve, të zgjedhë dhe të zgjidhet)
- Barazia juridike – parim sipas të cilit secili ka të drejtë për mbrojtje të barabartë juridike para gjykatave dhe organeve tjera gjyqësore dhe secili është i barabartë në procedurën para gjykatave
- Barazia shoqërore – parim sipas të cilit secili ka mundësi të barabarta për zhvillimin e aftësive dhe potencialeve të veta, për fitimin e diturive dhe për marrje e pozitës së caktuar në shkallët e shoqërisë.
- Barazia ekonomike – parim sipas të cilit secili ka të drejtë për trajtim të barabartë në marrëdhëniet ekonomike, në distribuimin e pasurisë shoqërore dhe në mundësitë për shfrytëzimin e resurseve ekonomike në shtet
- Barazi para ligjit – parim sipas të cilit ligjet dhe aktet nënligjore vlejnë njëllëj për të gjithë qytetarët në situata të njëjta ose të ngjashme (njerëzit janë subjekte të dispozitave të njëjta ligjore dhe individët dhe grupet nuk kanë privilegje të veçanta ligjore)
- Barazia e trajtimit – parim sipas të cilit individët, strukturat dhe organizatat, veprojnë me të gjithë në mënyrë të njëjtë në situata të njëjta ose të ngjashme.

■ Barazi e rasteve (mundësive)

Barazia e rasteve në vete nënkupton masat të cilat ndërmerren nga ana e shtetit, me qëllim që të vendosen njerëzit në situata të njëjta për praktikizmin e të drejtave dhe lirive themelore.

Në kuptimin më të gjerë të fjalës, barazia e rasteve nënkupton krijimin e atmosferës, rrethimit ku njerëzit do të mund t'i realizojnë dhe të praktikojnë të drejtat e tyre, gjegjësisht, do të inkuadrohen në jetën dhe aktivitetet shoqërore.

Kjo mund të nënkuptojë: distribuim i drejtë i resurseve shoqërore, standardizimi i kriterëve, kushte të barabarta për arsimim dhe punësim, kriterë të njëjta për shpërblim dhe avancim në karrierë etj.

Nacion i lidhur ngushtë me barazinë e rasteve është pabarazi faktike. Për pabarazinë faktike bëhet fjalë kur ekziston barazi ligjore dhe formale-juridike, por nuk janë krijuar kushte ku njerëzit do të mund të trajtohen barabartë, gjegjësisht ku do të mund në mënyrë të barabartë t'i gëzojnë dhe t'i praktikojnë të drejtat dhe liritë.

14

Pabarazia faktike shpesh lidhet me ekzistimin e situatës paraprake të vazhduar të trajtimit jo të barabartë: pabarazi mes gruas dhe burrit, pabarazi të pjesëtarëve të bashkësive etnike të pakicave, religjioze, gjuhësore.

Për shembull, në ligjet nuk ekzistojnë dispozita diskriminuese me të cilat kufizohet avancimi në karrierë i grave në mënyrë të njëjtë si dhe meshkujt, por në numër të madh, në pozita udhëheqëse në shtet emërohen meshkuj.

Pabarazia faktike mund të jetë rezultat i rrethanave objektive: pabarazia që del nga invaliditeti i personave të caktuar, moshë, vendi i banimit.

Për shembull, në shikim të parë kushte të njëjta, zyra të caktuara janë të paarrtshme për personat e moshuar ose për persona me invaliditet fizik. Ose, njerëzit që jetojnë në rajonet rurale nuk kanë qasje deri te institucionet kulturore të shtetit.

■ Bindja

Sistem i të kuptuarit dhe vlerave të një njeriu të cilat e udhëheqin në jetë dhe në kuadër të cilave e definojnë dallimin mes të mirës dhe të keqes. Në sistemin e bindjeve marrin pjesë bindjet religjioze dhe ideologjike, por vetë fjala ka rëndësi shumë të gjerë dhe në vete i inkorporon të gjitha llojet e ateizmit, skepticizmit, antiteizmit.

Sipas praktikës së Gjyqit Evropian për të Drejtat e Njeriut, ateizmi është besim i barabartë me ato religjioze dhe askush nuk guxon të diskriminojë person për shkak se është ateist.

Për shkak të zgjerimit të përfshirjes së situatave, në kohët më të reja përdoret edhe shprehja “filozofia jetësore” si sinonim i bindjes.

■ Barrë e dëshmimit

Nëse pala që ankohet se është viktimë e diskriminimit nxjerr fakte të cilat arsyetojnë dyshimin se është bërë diskriminim i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, pala e akuzuar duhet të dëshmojë se e drejta e trajtimit të barabartë nuk është shkelur.

Ndryshimi i drejtimit të dëshmimit është bërë për shkak të asaj se ata që diskriminojnë kanë në dispozicion mënyra të shumta për ta fshehur diskriminimin, shumë shpesh bëhet fjalë për stereotipa dhe paragjykime tradicionalisht prezent, ndërsa në një pjesë të rasteve ata që diskriminojnë nuk janë të vetëdijshëm se e bëjnë këtë.

Në raste të caktuara (kur bëhet fjalë për bazat e diskriminimit të cilat bazohen në paragjykime thellë të rrënjëzuara, si për shembull gjinia ose orientimi seksual) aplikohet instituti: supozimi i diskriminimit. Kjo do të thotë se përkatësia ndaj një grupi të caktuar mund të vlerësohet si e mjaftueshme që të inicohet rast i diskriminimit të mundshëm dhe t'i ndërrohet drejtimi peshës së dëshmimit nëse aplikuesi dëshmon se ekziston lidhje mes bazës konkrete për diskriminim dhe aktivitetit që është bërë.

D

Diskriminimi

Diskriminim i drejtpërdrejtë


Shembuj të tjerë të diskriminimit jo të drejtpërdrejtë

Diskriminim sistemor

Dokumente ndërkombëtare

Diskriminimi i multiplikuar

Durimi i një veprimi të caktuar



Fjalori i shprehjeve lidhur me diskriminimin



■ Diskriminimi

Për nevojat e këtij ligji, diskriminimi definohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose veprim jo i barabartë ose mosveprim, e motivuar nga bazat që u përmendën (të cilat ekzistojnë për momentin, ose kanë ekzistuar më herët e nuk ekzistojnë për momentin, ose mund të ekzistojnë në të ardhmen, ose që i referohet një personi të caktuar), e që ka për qëllim ose rezulton me pamundësimin ose vështirësimin e pranimit, gëzimit ose praktikizmin nga ana e të gjithë personave mbi bazë të barabartë të gjitha të drejtave dhe lirive, gjegjësisht në trajtimin e pavolitshtëm të një personi lidhur me tjetrin në situatë të ngjashme.

Që një situatë e caktuar të mund të identifikohet si diskriminuuese është e nevojshme të ketë tre vepra komplementare të definicionit të diskriminimit:

1. Aktiviteti (çdo dallim, përjashtim, kufizim ose veprim jo i barabartë ose mosveprim)
2. Baza e diskriminimit (i dhënë në kushtetutë, në ligjet ose në dokumentet ndërkombëtare)
3. Pasojat nga diskriminimi (jo mundësimi ose vështirësimi i pranimit, gëzimit ose praktikizmi nga ana e të gjitha personave mbi bazë të barabartë të gjitha të drejtave dhe lirive, gjegjësisht në trajtim të pavolitshtëm të një personi lidhur me personin tjetër në situatë të ngjashme)

Si diskriminuuese do të llogaritet: çdo sjellje aktive ose pasive nga ana e autoriteteve publike, si dhe nga ana e personave juridik dhe fizik në jetën publike dhe sektorët publik, që krijojnë bazë për privilegjimin ose deprivilegjimin në mënyrë të paarsyeshme, të personit, një grupi njerëzish ose bashkësisë, ose që i ekspozon në raport jo të drejtë dhe degradues në krahasim me personat tjerë, grup personash ose bashkësi në situatë të ngjashme të bazuar në ndonjë bazë diskriminuuese.

Veprimi i caktuar mund të paraqesë akt të diskriminimit pavarësisht nga ajo:

- gjatë intervistës për punësim, punëdhënësi pyet nëse aplikuesi për punë grua ka fëmijë dhe përgjigja pozitive në pyetjen rezulton me refuzimin e kandidatit me arsyetimin se nuk është adekuate për atë vend pune, për shkak se fëmijët kërkojnë shumë kujdes dhe ekziston rreziku të mungojë në punë
- konkursi për punësim ka të bëjë vetëm për pjesëtarët e njërës gjini pa ekzistimin e shkakut të arsyeshem ligjor
- kur është paraparë kufiri i moshës për punësimin e parë pa ekzistimin e shkakut të arsyeshem ligjor

■ Diskriminimi jo i drejtpërdrejtë

Për diskriminim jo të drejtpërdrejtë bëhet fjalë kur:

- Rregull ose kusht i caktuar që aplikohet ndaj të gjithëve, mund ta plotësojë një përqindje e vogël e njerëzve nga një grup i caktuar konkret, për çka pjesëtarët e atij grupi të njerëzve janë vënë në situatë të pavolitshme dhe,
- Kur efektet nga kërkesa, kushte dhe praktika të caktuara kanë ndikim jo proporcional më negativ ndaj një grupi të caktuar të njerëzve), ndërsa me vetë rregullën (kushtin) nuk mund të arsyetohet me kriter të domosdoshëm për punën konkrete.

Në rast të diskriminimit jo të drejtpërdrejtë ndërmerren veprime jo diskriminuese të cilat kanë ose mund të kenë efekt diskriminues.

Diskriminimi jo i drejtpërdrejtë është më pak i dukshëm se ai i drejtpërdrejtë dhe shpesh mund të mos vërehet.

Ekzistimi i diskriminimit të drejtpërdrejtë në vendin e punës mund të detektohet me parashtrimin e pyetjeve në vijim (sipas renditjes së dhënë):

1. I punësuari a është shpallur për tepriçë teknologjike ose nuk është promovuar për shkak të pamundësisë t'u përgjigjet kërkesave dhe kushteve të caktuara të dhëna për momentin konkret?

2. Këto kërkesa ose kushte a janë neutrale dhe mund të aplikohen ndaj të gjithë të punësuarve?
3. A ka qenë obliguese plotësimi i kërkesës ose kushtit me qëllim të shmangies nga largimi nga puna ose për shkak të fitimit të promovimit?
4. Nëse kërkesën ose kushtin mund ta plotësojnë në mënyrë proporcionale një numër drastik më i vogël i pjesëtarëve të një grupi konkret?
5. A mund ai që e ka parashtruar lutjen ose kushtin të dëshmojë se ekzistimi i të njëjtit është i arsyeshëm për punën konkrete?

Shembuj të tjerë të diskriminimit jo të drejtpërdrejtë:

1. Në konkursin për punësim kërkohen karakteristika të caktuara fizike të aplikuesi, të cilat nuk paraqesin kusht themelor për kryerjen e një pune të caktuar (gjinia të kamerierët, kufiri shumë i ulët i moshës të stjuardët dhe stjuardesat).
2. Kërkesa për nivel të caktuar të shëndetit fizik si kusht i domosdoshëm për regjistrim në Akademinë policore (edhe krahas asaj që studimi në Akademinë policore aspak nuk do të thotë punësim në pozita të caktuara në polici).
3. Ndërtesë publike që ka ashensorë, por qasja deri te ato është nëpërmjet dhjetë shkallëve të hyrjes kryesore. Ekziston mundësia ata që shfrytëzojnë karroca invalide ose vështirë lëvizin të arrijnë deri te ashensorët nëpërmjet hyrjes së prapme të paraparë për shkarkimin e prodhimeve.
4. Kërkesa për lartësi minimale të pagës pa shkak të veçantë dhe pa rëndësi thelbësore për punën (një numër i madh i personave me prejardhje aziatike mund të vendosen në pozitë të deprivilegjuar për shkak të një kërkesë të tillë)
5. Të gjitha informatat për përdorimin e ilaçeve të caktuara janë dhënë vetëm në gjuhën maqedonase (me çka vihen në pozitë të pavolitshme shfrytëzuesit e ilaçeve, të cilët nuk e flasin mirë gjuhën maqedonase, për çka është e sigurt se përdorimi i ilaçeve kërkon saktësi të madhe)

■ Diskriminim sistemor

Mënyra e diskriminimit ku në vazhdimësi përdoren praktika, mjete, politika ose procedura, të cilat si rezultat kanë përjashtimin e një grupi të caktuar ose kufizimin e mundësive për punësim, shkollim, avancim etj. të pjesëtarëve të grupit konkret të njerëzve.

Për shembull: pozita në të cilën gjenden personat me handicap mendor mund të llogaritet s pasojë e diskriminimit sistemor, që manifestohet në politikën, strategjinë, jo adekuate, mos reagimin ndaj praktikave joadekuate, mungesa e sanksioneve në rast të shkeljes së drejtave të personave me handicap mendor.

■ Dokumente ndërkombëtare

Dokumentet të cilat aprovohen nga ana e organeve qeveritare ndërkombëtare (në nivel të OKB, në nivel rajonal ose nga ana e strukturave të posaçme ndërkombëtare), e të cilat Republika e Maqedonisë i ka pranuar me anë të: anëtarësismit, nënshkrimit ose ratifikimit. Nën dokumente ndërkombëtare nënkuptohen:

- Akte juridike jo obliguese (deklarata, rezoluta, rekomandime etj.) për të cilat Maqedonia ka deklaruar ose ka dëshmuar se do t'i respektojë (për shembull: Deklarata universale për të drejtat e njeriut);
- Marrëveshje ndërkombëtare (pakte, konventa, karta, rezoluta etj.) të cilat me aktin e ratifikimit janë bërë pjesë të legjislatives nacionale (për shembull: Pakti ndërkombëtar për të drejta ekonomike sociale e kulturore, Konventa për të drejtat e fëmijëve, Konventa evropiane për të drejtat e njeriut) dhe të cilat janë të lidhura me plotësimin e obligimeve konkrete nga ana e shtetit (në formë raportesh, ndryshime në ligjet dhe praktikë, pranimi i kontrollit të jashtëm etj.)

■ Diskriminimi i multiplikuar

- Diskriminimi i personave ose grupi të caktuar, që mund të bëhet për shkak të shumta.

- Për shembull, gruaja rome mund të paraqitet si viktimë e diskriminimit në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike dhe mbi bazë të statusit social dhe ekonomik.
- Pasojat nga ky lloj i diskriminimit reflektohen në përjashtimin e përgjithshëm të personave të cilët kanë qenë të ekspozuar nga jeta publike dhe marginalizimi i tyre i plotë nga të gjitha ndodhitë e bashkësisë më të gjerë.

■ Durimi i një veprimi të caktuar

Të durohen pasojat nga aktivitetet e drejtuara nga pengimi i diskriminimit dhe të ndërmerren veprime, me të cilat do të pengohet ose dot ë kufizohet veprimi i këtyre aktiviteteve.

Nënkupton mungesë të kundërshtimit të personit dhe subjekteve juridike, të cilat janë përmendur si shkelës të ligjit në raport me masat me të cilat vendoset situatë e mëparshme ose e re e diskriminimit.

24

Për shembull: largimi i mbishkrimeve me të cilat ndalohet hyrja e një grupi të caktuar, ose anulimi i konkursit, ndalesa e shkrimeve ose emisioneve në medime etj.

■ Durimi i një veprimi të caktuar

Të durohen pasojat nga aktivitetet e drejtuara nga pengimi i diskriminimit dhe të ndërmerren veprime, me të cilat do të pengohet ose dot ë kufizohet veprimi i këtyre aktiviteteve.

Nënkupton mungesë të kundërshtimit të personit dhe subjekteve juridike, të cilat janë përmendur si shkelës të ligjit në raport me masat me të cilat vendoset situatë e mëparshme ose e re e diskriminimit.

Për shembull: largimi i mbishkrimeve me të cilat ndalohet hyrja e një grupi të caktuar, ose anulimi i konkursit, ndalesa e shkrimeve ose emisioneve në medime etj.

A large, bold, black letter 'G' is centered on the page. The letter is a simple, sans-serif font with a thick stroke. The top curve is rounded, and the bottom curve is also rounded but ends in a small, sharp hook that points downwards and to the right. The letter is set against a white background.

Grup i marginalizuar (i dobët)
(përkitja në një grup të marginalizuar si bazë për diskriminim)

■ Grup i marginalizuar (i dobët) (përkitja në një grup të marginalizuar si bazë për diskriminim)

Grup i individëve të cilët i bashkon: pozita specifike në shoqëri (jashtë nga qendrat e fuqisë, të ekspozuar në përjashtim social), të cilët janë objekt i paragjykimëve, të cilët kanë karakteristikë të veçanta dhe të cilët i bëjnë të volitshëm për lloje të dhunës së caktuar, kanë mundësi më të vogël për praktikumin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre ose janë të ekspozuar nga mundësia e madhe për viktimizim të mëtejshëm.

Zakonisht këtu marrin pjesë njerëzit për të cilët ekziston mundësi e madhe që të diskriminohen (në baza të ndryshme).

Këto janë njerëz që janë vënë në situata të pabarazisë, pozitivë jo e volitshme ose ballafaqohen me refuzim nga popullata shumicë për shkak të ndarjes nga ajo shumicë:

a) me ndonjë karakteristikë të tyre – prejardhje sociale ose etnike, invaliditet;

Për shembull: policia mund të bëjë hetime adekuate për vdekjen ose lëndimin e një personi pa shtëpi ose të mos reagojë në rast të ofendimit dhe poshtërimit të një pjesëtari të bashkësisë rome.

b) rrethana specifike – sëmundje kronike (jo)infektive, (HIV) AIDS, varshmëri nga përdorimi i drogave narkotike;

Për shembull: stomatologu refuzon të ndërtojë te personi i infektuar nga AIDS, ose mjeku i përgjithshëm refuzon të ndërtojë te personi që përdor mjete narkotike.

c) status i caktuar – refugjat, kërkues i azilit, person i zhvendosur brenda vendit, person pa shtëpi;

Për shembull: nuk u lejohej lëvizja e lirë, ose, nuk ju mundësohet arsimimi i fëmijëve.

ç) ndonjë përcaktim personal – punëtoresh seksuale, persona transgjjinor dhe transfamiljar.

G

Për shembull: policia refuzon të marrë fletëparaqitje për dhunë të kryer mbi punëtoren seksuale, ose, punëdhënësi refuzon të punësojë person transfamiljar.

Margjinalizimi mund të paraqitet në nivel individual, në nivel të bashkësisë dhe në nivel global-strukturor. Në secilën prej këtyre niveleve marginalizimi paraqet formë specifike të refuzimit nga ana e njerëzve të tjerë.

Grup i marginalizuar specifik janë fëmijët. Margjinalizimi i fëmijëve shpesh herë është e mbuluar me kujdesin deklarativ për interesimin më të mirë të fëmijëve.

Margjinalizimi i fëmijëve ka të bëjë veçanërisht me realizimin e të drejtës të: shprehurit, mendimit dhe besimit, shoqërimit etj.



GJ

Gjendja martesore dhe familjare (si bazë e diskriminimit)
Gjendja familjare (statusi familjar si bazë për diskriminim)
Gjuha (si bazë e diskriminimit)
Gjinia (si bazë për diskriminim)

■ Gjendja martesore dhe familjare (si bazë e diskriminimit)

Sipas gjendjes martesore meshkujt dhe femrat të moshës madhore mund të jenë: vetmitarë, në martesë, në bashkësi jashtë martesore, të shkurorëzuar, i vejë/vejushe, në martesë me jetë të ndarë.

Si bazë e diskriminimit, gjendja martesore, do të thotë trajtim më i pavolitshëm ose negativ të një personi të caktuar për shkak të formës së jetës së përbashkët me personin tjetër, ose mungesa e jetës së tillë të përbashkët.

Statusi martesor mund të paraqitet si bazë për diskriminim, për shembull, në raste kur preferohet punësimi i gruas e cila nuk është e martuar (për shkak të supozimit se do të jetë më pak e zënë me punë dhe se nuk do të shfrytëzojë ditë për kujdesin ndaj fëmijëve), gjegjësisht, mashkulli i cili është i martuar (për shkak të supozimit se do të jetë më stabil lidhur me obligimet e punës).

Diskriminimi mund të jetë i lidhur me statusin e partnerit bashkëshortor. Për shembull, mund të shkurtohet punësimi ose avancimi në punë pasi që njëri nga partnerët tashmë punon për punëdhënësin e njëjtë. Ose, dikush mund të largohet nga puna për shkak se partneri i tij ka filluar të merret me biznes konkurrues.

Një lloj i pyetjeve të caktuara të cilat parashtrohen gjatë intervistës për punësim, e të cilat kanë të bëjnë me statusin martesor ose familjar të aplikuesit, mund të trajtohen si diskriminuese, gjegjësisht të shkojnë drejt diskriminimit. Të tilla janë pyetjet: “A jeni të martuar”, “A keni familje”, “Si e keni emrin tuaj të kurorëzimit”, “A jeni shtatzënë”, ose “A planifikoni të keni familje”.

Diskriminimi në bazë të gjendjes martesore mund të shoqërohet edhe me forma tjera të diskriminimit (në bazë të: rolit prindëror, shtatzëni, përgjegjësi për kujdesin ndaj anëtarit të familjes).

Shkurorëzimi mund të paraqesë shkak të posaçëm për diskriminim.

Manifestohet në trajtim të pavolitshëm të personave të shkurorëzuar me arsyetimin se ata janë të pasigurt dhe të papërshtatshëm për vende të caktuara pune.

Lidhur me statusin martesor dhe familjar si baza për diskriminim, është problematike çështja e partnerëve homoseksual, të cilët deri tani nuk janë trajtuar në të gjitha marrëdhëniet juridike njëloj si partnerët heteroseksual.

■ Gjendja familjare (statusi familjar si bazë për diskriminim)

Marrëdhëniet mes njerëzve të cilat bazohen në raportin prind/kujdestar-fëmijë, dhe raporti mes farefisëve (të gjakut dhe ligjor). Konkretisht, kjo është lidhje e cila rrjedh nga farefisni të gjakut (raporti mes paraardhësve dhe pasardhësve, si prindër dhe fëmijë, por edhe breza më të largët, mes vetë vëllezërve dhe motrave nga martesa ose jashtë martesor, raporti mes tezeve, dajallarëve, hallave/xhaxhallarëve me nipa/mbesa, raporti mes kushërirave), lidhja martesore (mes bashkëshortëve ose mes farefisni të gjakut-farefisni sipas krushqisë), lidhja nga adoptimi. Lidhjet familjare (pavarësisht nga ajo nëse bëhet fjalë për të gjakut ose ligjore) mund të paraqesin bazë për fitimin ose humbjen e privilegjeve, trajtimi, shërbimet.

Ndalesa e diskriminimit në bazë të kësaj do të thotë ndalesa që të trajtohet ndonjë person më keq, për shkak të faktit se gjendet në lidhje të këitillë të caktuar (status familjar).

Për shembull, lloji i këitillë i diskriminimit llogaritet diskriminimi i fëmijëve të lindur jashtë martesës (fëmijë jashtë martese) në krahasim me ata të lindurit në martesë. Ose kur, punëdhënësi nuk dëshiron të punësojë grua ose burrë të cilët kanë obligim të kujdesen për anëtar të familjes më të ngushtë ose më të gjerë.

Si akt i diskriminimit të jo drejtpërdrejtë mund të llogaritet parashtrimi i kërkesës që nuk mund të jetë e arsyeshme me nevojën thelbësore të

punës, ndërsa e cila në mënyrë të ndryshme ndikon mbi personat e cilët kanë status specifik familjar.

Për shembull, ndërmarrja insiston të gjithë të punësuarit të punojnë tej orarit të punës gjatë vikendeve që do të thotë se i punësuarit që është i vejë me fëmijë të vogël, nuk mund të ballafaqohet me kusht të tillë.

Diskriminimi në bazë të statusit familjar mund të ndodh në rast kur avancimi në shërbim, punësim dhe largim nga puna lidhet me prezencën e anëtarit të familjes të personit i cili kushtëzohet.

■ Gjuha (si bazë e diskriminimit)

Nën gjuhën nënkuptohet çdo sistem i komunikimit mes njerëzve nëpërmjet cilit me përdorimin e zërit, trupit ose simboleve, njerëzit i shprehin idetë dhe mendimet e tyre dhe i shkëmbejnë me të tjerët.

Diskriminimi në bazë të gjuhës mund të sillet në trajtim të pavolitshëm të individit ose grup të njerëzve për shkak përdorimit të gjuhës personale (amë) ose për shkak të ekzistimit të ndonjë karakteristike tjetër të gjuhës (theksi, dialekti, gjuha e simboleve, alfabeti i Brajtit, prekja e trupit si mënyrë e shprehjes).

Për shembull, mund të bëhet fjalë për diskriminimin në bazë të gjuhës në rast kur punëdhënësi refuzon të punësojë nëpunës i cili e flet rrjedhshëm gjuhën e komunikimit që kërkohet, por me theks të theksuar të huaj. Ose, kur personi nuk është pranuar në punë për shkak të mosnjohjes së gjuhës zyrtare, edhe krahas asaj që gjuha nuk është kriteri thelbësor për kryerjen e detyrave.

Diskriminimi në bazë të gjuhës në kuptimin më të gjerë mund të ketë bëjë edhe me mospranimin e llojeve të ndryshme të komunikimit, gjegjësisht, trajtim i ndryshëm i njerëzve për shkak të mënyrës në të cilën shprehen (ku renditen edhe llojet e ndryshme të komunikimit verbal si pjesë nga mënyra tradicionale e komunikimit).

Për shembull: refuzimi të pranohet dëshmia e dëshmitarit shurdhmemec, i cili mund të japë deklaratë nëpërmjet gjuhës së shenjave. Ose, mungesa e informatave të shkruara me alfabetin e Brajtit.

■ Gjinia (si bazë për diskriminim)

Paraqet përcaktim biologjik të identitetit të një personi me të cilën lindin njerëzit. Gjinia përcaktohet sipas dallimeve biologjike (më së shumti sipas organeve reprodutive) dhe i definojnë njerëzit si meshkuj dhe femra.

Shuma e karakteristikave biologjike me të cilën përcaktohen njerëzit si meshkuj dhe femra nuk është tërësisht ekskluziv pasi që ka individë të cilët i kanë karakteristikat e të dy gjinive.

Diskriminimi i bazuar në gjini do të thotë trajtim i keq ose veprim me individin të bazuar kryesisht në gjininë si karakteristikë dhe më shpesh e lidhur me reproduksionin dhe me karakteristikat specifike të mashkullit dhe femrës.

Për shembull: refuzimi të punësohet një grua pasi që është shtatzëne (ose mund të mbetet shtatzënë) paraqet diskriminim gjinor. Ose, shpallja e konkursit për pozicionin kamerier kërkohen vetëm persona të gjinisë femërore, paraqet diskriminim për të gjithë meshkujt dhe njerëzit transseksual.

34

■ Gjinia (si bazë për diskriminim)

Koncept i krijuara shoqëror i mashkullisë dhe femërisë që përbëhet nga cilësi ose karakteristika adekuate, të cilat pritet t'i kenë pjesëtarët e secilës gjini (rolet gjinore). Gjinia ka të bëjë me dallimet në rolet sociale dhe përgjegjësitë që i jepen femrave dhe meshkujve nga ana e bashkësisë. Gjinia është kategori shoqërore dhe i përcakton rolet shoqërore të cilat pritet t'i ketë burri dhe gruaja në jetën publike dhe private.

Këto role janë të ndryshueshme dhe varen nga bashkësia dhe nga konteksti historik. Mund të përcillen nëpërmjet: religjionit, arsimit, shkencës, ligjeve, praktikave kulturore dhe sistemit social.

Në rast të diskriminimit të bazuar në gjini dallimi që bëhet nuk është vetëm për shkak të gjinisë si karakteristikë biologjike, por për shkak të

supozimit se një person duhet të ketë rol të caktuar në shoqëri. Nëse dallimi bëhet vetëm në bazë të gjinisë (diskriminohet ndonjë person vetëm për shkak të faktit se është femër) bëhet fjalë për diskriminim gjinor. Çdo gjë tjetër është diskriminim gjinor. Gjinia referon në role sociale të përcaktuara dhe karakteristika të cilat ndërlidhen me gjininë e tyre. Do të thotë, fokusi është në rolet stereotip të pjesëtarëve të një gjinie (më së shpeshti ai femëror) në shoqëri (më së shpeshti, familja).

Për shembull, nëse në legjislacionin punues ekzistojnë dispozita me të cilat mundësohet mungesa nga puna (e paguar ose pa pagesë) për shkak të kujdesit të fëmijëve vetëm për pjesëtarët e gjinisë femërore, llogaritet se bëhet fjalë për diskriminim gjinor, pasi që niset nga ideja stereotipie se vetëm nënat mund t'i ushqejnë, të kujdesen dhe t'i rrisin fëmijët (që nuk është e lidhur me karakteristikat biologjike të gruas por me stereotipat për rolin e saj në bashkësi).

A large, bold, black letter 'H' is centered on the page. It consists of two vertical bars connected by a horizontal bar in the middle.

Homofobia

Fjalor i shprehjeve lidhur me diskriminimin

Qëndrim irracional, mosdurim dhe urrejtja e drejtuar nga homoseksualitet dhe lezbejkat. Bindje tipike homotobike, është se homoseksualiteti është panatyrshëm, se është semundje, perversion, i rrezikshëm. Qëndrim irracional, mosdurim dhe urrejtja e drejtuar nga homoseksualitet dhe lezbejkat. Bindje tipike homotobike është e panatyrshme, se është semundje, perversion, i rrezikshëm. Qëndrim irracional, mosdurim dhe urrejtja e drejtuar nga homoseksualitet dhe lezbejkat. Bindje tipike homotobike është e panatyrshme, se është semundje, perversion, i rrezikshëm. Qëndrim irracional, mosdurim dhe urrejtja e drejtuar nga homoseksualitet dhe lezbejkat. Bindje tipike homotobike është e panatyrshme, se është semundje, perversion, i rrezikshëm.



■ Homofobia

Qëndrim irracional, mosdurim dhe urrejtja e drejtuar nga homoseksualët dhe lezbejkat. Bindje tipike homofobike është se homoseksualiteti dhe lezbejkat. Bindje tipike homofobike është se homoseksualiteti dhe lezbejkat.

Homofobia në vete përmban nivel shumë të ulët të emocioneve të cilat nxisin sjellje agresive ndaj personave me orientim jo heteroseksual.

Aktet e nxitura nga homofobia mund të përbëhen në sulme verbale dhe fizike dhe mund të përmbajnë komente ofenduese, poshtëruese dhe degraduese.

Homofobia veçanërisht është e rrezikshme kur përdoret si arsytim për aksione të dhunshme kundër homoseksualëve.

■ Të huajt

Njerëz që nuk kanë nënshtetësi të shtetit që për momentin gjenden në atë territor. Ndaj statusit të huajt ndikon legaliteti i qëndrimit në territorin e shtetit konkret.



Identiteti etnik (si bazë për diskriminim)

Identiteti

Invaliditeti (si bazë e diskriminimit)

Interesi legjitim

■ Identiteti etnik (si bazë për diskriminim)

Identiteti etnik është përkatësia e njerëzve në një bashkësi, ku ata e ndajnë prejardhjen e përbashkët dhe paraardhësit (gjen-eza), gjuhën, kulturën, zakonet, religionin, si dhe ndjenjën dhe vetëdijen se i takojnë bashkësisë së njëjtë ku ata i ndajnë mitet dhe simbolet e përbashkëta.

Diskriminimi në bazë etnike do të thotë trajtimi i ndryshëm i individit sepse i takon një bashkësie konkrete etnike, ku me pjesëtarët tjerë të asaj bashkësie e ndan identitetin e përbashkët etnik.

Pjesëtarët e një bashkësie etnike shpesh herë kanë edhe karakteristika të njëjta fizike (ngjyra e lëkurës, forma e syve, ngjyra e flokëve), që bëhet pjesë e identifikimit të tyre (si nga ana e tyre ashtu edhe nga ana e të tjerëve). Kjo nuk e përjashton mundësinë, njerëz me karakteristika të ngjashme fizike t'i takojnë bashkësive të ndryshme etnike, si dhe persona me karakteristika të ndryshme fizike t'i takojnë një bashkësie etnike.

Përkatësia etnike dallohet nga shtetësia si lidhje mes një personi me një shtet. Në një shtet mund të ekzistojnë më shumë bashkësi etnike. Por, diskriminimi është i mundur në bazë të përkatësisë etnike që të përputhet me diskriminimin në bazë të nënshtetësisë.

Për shembull, diskriminimi i një hebraiku në Republikën e Maqedonisë mund të komentohet edhe si diskriminim në bazë të nënshtetësisë (lidhja me shtetin e Izraelit), edhe si diskriminim në bazë të përkatësisë etnike.

Në disa raste, mund të përputhen më shumë baza të diskriminimit. Kështu, për shembull, diskriminimi i hebraikut mund të jetë në bazë etnike, racore, fetare dhe në bazë të nënshtetësisë, pasi që hebrenjtë llogariten edhe si grup i veçantë etnik, racor dhe fetar. Në raste të këtilla, dallimi sipas nënshtetësisë mund të iniciohet çështja e diskriminimit jo të drejtpërdrejtë në bazë të tjerave (për shembull, racës).

■ Identiteti

Vetëdije për veten si pjesëtar i një grupi të caktuar etnik, kulturor, religjioz ose tjetër, që dukshëm dallohet për ndonjë karakteristikë ose dispozitë të pranishme të vazhdueshme (ose në periudhë më të gjatë kohore) e cila i bashkon pjesëtarët e saj.

■ Invaliditeti (si bazë e diskriminimit)

Nën termin invalidë zakonisht nënkuptohet, pengesë e lindur ose e fituar, pengesë e përhershme ose e përkohshme fizike, mendore, intelektuale ose e shqisave të aftësive funksionale të individit.

Si person me invaliditet llogaritet çdo individ i cili ka lëndim fizik ose mendor, e që në masë të dukshme e kufizon individin në kryerjen e një ose më shumë aktiviteteve jetësore ose perceptohet si kufizuese për kryerjen e një numri të caktuar të aktiviteteve. Invaliditeti dallohet nga sëmundja para së gjithash për shkak të kohëzgjatjes (vazhdimi) të ekzistimit.

44

Për ekzistimin e invaliditetit si bazë e mundshme e diskriminimit nuk është e rëndësishme nëse invaliditeti është shkaktuar nga lëndimi ose sëmundja që ka ekzistuar nga lindja, i cili është paraqitur më vonë ose realisht pritet që të paraqitet.

Invaliditeti si bazë e diskriminimit është vështirë të definohet, ndërsa nëse e shohim si krahasim, ndryshe definohet. Kjo ndodh për shkak se invaliditeti paraqet gjendje të trupit dhe mendjes dhe dallimi mes invaliditetit dhe jo invaliditetit shpesh është shumë i vogël. Sipas Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, ekziston dallim mes invaliditetit dhe sëmundjes. Në të vërtetë, kufizimi që ekziston te individit, që të bie nën termin “invaliditet” duhet të zgjasë një kohë më të gjatë. Për shkak të këtij qëndrimi të Gjykatës, në Gjermani dhe Austri kërkohet që kjo pengesë të ekzistojë më së paku 6 muaj, në Britaninë e Madhe duhet të zgjasë një vit, derisa në Qipro dhe Suedi duhet të jetë e përhershme.

Sjellja jo diskriminuese me personat me invaliditet në vete i përmban

të gjitha aktivitetet e shtetit të orientuara drejt krijimit të kushteve për praktikizmin e barabartë të drejtave. Për shembull: adaptime arkitektonike, beneficione të veçanta për personat me invaliditet në fushën e arsimit dhe mbrojtjes sociale, lehtësime tatimore për punësimin e personave me invaliditet, dhënia e veglave për ndihmë dhe materialeve që do të ndihmonin arritjen e barazisë faktike (audio materiale nga të gjitha fushat për fëmijët me shikim të dëmtuar, përkthimet e filmave dhe sigurimi i përkthimit në gjuhën e shenjave për personat me dëgjim të dëmtuar, botimi i librave me alfabetin e Brajlit, zhvillimi i programeve inkluzive për arsimin e fëmijëve me pengesa mentale).

■ Interesi legjitim

Paraqet arsyetim për interesin dhe inkuadrimit aktiv të një subjekti të caktuar (person fizik ose juridik) në marrjen e aktiviteteve konkrete, për shkak është i prekur personalisht nga pasojat e atyre aktiviteteve, për shkak të interesimit të gjerë të shprehur më parë për ngjarje të caktuara shoqërore, gjegjësisht për shkak të autorizimeve të parapara me ligj për kryerjen e aktiviteteve të caktuara.

45

Legjitimitet aktiv kanë të gjithë ata të cilët mund të paraqiten si palë në kontest të caktuar (pavarësisht ose nga ana e tij/e asaj që kërkon diçka).

Për shembull: qytetarët kanë interes legjitim të dorëzojnë parashtresë deri te Gjykata kushtetuese për shkak të zgjidhjeve jokushtetare të caktuara ligjore, sepse ato zgjidhje ligjore mund të kenë pasoja për ata ose për më gjerë për bashkësinë ku jetojnë (pavarësisht nga ajo se në momentin e dorëzimit të parashtresës nuk janë prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë). Ose, shoqata e qytetarëve e cila merret me problematikën e personave me invaliditet ka të drejtë ta parashtrojë çështjen me situatën e personave të përkuajdesur në spitalet psikiatrike pavarësisht nga ajo se asnjë anëtar nga kjo shoqatë nuk është i prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga problemi i theksuar.

A large, bold, black letter 'J' is centered on the page. The letter has a thick, uniform stroke and a curved bottom that tapers slightly to a point on the left side. The top of the letter is a straight vertical line.

Jeta publike

■ Jeta publike


Veprimi i përgjithshëm dhe pjesëmarrja e njeriut jashtë shtëpisë së tij. Çdo gjë që i takon ose është e lidhur me funksionimin e kombit, shtetit ose bashkësisë.

Për shembull: pjesëmarrja publike e njerëzve para mediave, në diskutime, në konferenca, aktivitete të lidhura me punën ose aktivitete në ndonjë organizatë ose shoqatë qytetare, janë pjesë të jetës publike.

Përkundër jetës publike, jeta private definohet si: diçka që i takon individit, që ka të bëjë me një person dhe marrëdhëniet individuale në kuadër të shtëpisë, familjes, martesës, ose çdo gjë që paraqet interesim të veçantë lidhur me vetë individin, që nuk është e lidhur me të tjerët, personale.

Për shembull: mendimi personal, besimi, integriteti fizik i personalitetit, shtëpia, sendet personale, janë pjesë të jetës private.

Jeta private komentohet në përbërje të pacenueshmërisë së sferës fizike, pavarësisë së moralit, fesë personale, përkundër jetës publike, që numërohet në kuadër të normave të pranuar në përgjithësi dhe rregullave të sjelljes.

A large, bold, black letter 'K' is centered on the page. The letter is composed of three thick, solid black strokes: a vertical stem on the left, and two diagonal strokes that meet at a sharp point in the middle of the stem. The top diagonal stroke extends to the right, and the bottom diagonal stroke extends downwards and to the right. The overall style is minimalist and graphic.

Kultura
Kuotat
Ksenofobia

ultura Modele të jetës së përditshme të cilat
etëdihe ose pa vetëdihe janë mesuar (të pra
ga aria e një grupi njërezish dhe të cilat tr
nen në një periudhë më të gjatë kohore
ata në gjeneratë. Të gjitha bashkë kë
efinojnë mënyrën e jetës së një grupi
ercaktuara sipas gjinisë, religjionit,
nike, gjeografike) e cila i praktikor
e gjenerata. Në kuader të kultur
aktuara dhe përcaktime morale
en nga ana e pjesëtareve të a
senofobia Kultura Kuotat Kse
uotat Ksenofobia Kultura K
ra Kuotat Ksenofobia Kul
ultura Kuotat Ksenofobi
bia Kultura Kuotat Kse
senofobia Kultura Kur
uotat Ksenofobia Ki
ra Kuotat Ksenofo
ërditshme të cilat
esuar (të pran
ne të cilat tran
atë kohore n
ashkë këto m
e një grupi konk
ligjionit, përkatë
raktikon në vazhdi.
kulturave ka rregull
orale të cilat respekt
asal kulture. Kuotat K
senofobia Kultura Kuota
uotat Ksenofobia Kultura
ra Kuotat Ksenofobia Kulu
ultura Kuotat Ksenofobia Kul
bia Kultura Kuotat Ksenofobia
senofobia Kultura Kultura Mode
ërditshme të cilat me vetëdihe os
esuar (të pranuar) nga ana e një
ne të cilat transmetohen në një beh
atë kohore nga gjenerata në gjenerat
ashkë këto modele e definojnë mënyr
e një grupi konkret (të përcaktuara sipas
ligjionit, përkatësisë etnike, gjeografike)
aktikon në vazhdimësi me gjenerata. Në k
kulturave ka rregulla të caktuara dhe përca.

Fjalor i
shprehjeve
lidhur me
diskriminimin



■ Kultura

Modele të jetës së përditshme të cilat me vetëdije ose pa vetëdije janë mësuar (të pranuar) nga ana e një grupi njerëzish dhe të cilat transmetohen në një periudhë më të gjatë kohore nga gjenerata në gjeneratë. Të gjitha bashkë këto modele e definojnë mënyrën e jetës së një grupi konkret (të përcaktuara sipas gjinisë, religjionit, përkatësisë etnike, gjeografike) e cila i praktikon në vazhdimësi me gjenerata. Në kuadër të kulturave ka rregulla të caktuara dhe përcaktime morale të cilat respektohen nga ana e pjesëtarëve të asaj kulture.

Këto modele mund të pasqyrohen te gjuha, praktikat e zakonshme në jetën e përditshme, art, zakonet, kremtimi i festave, ushqimi, religjioni, ritualet në sfera të ndryshme të jetës së përditshme, veshja.

■ Kuotat

53

Numër i obliguar, fiks i pozitave ose vendeve të cilat mund të plotësohen vetëm nga përfaqësuesit e bashkësisë së caktuar të pakicave. Arrihen me rregulla nga më parë të shkruara dhe të pranuar sipas të cilave vende të caktuara pune, struktura politike ose në kuadër të arsimimit rezervohen për numër të caktuar të pjesëtarëve të ndonjë bashkësie të pakicave.

Kuotat ekzistojnë me qëllim të barazimit të prezencës së pjesëtarëve të grupeve të ndryshme në strukturat ku kjo prezencë është dukshëm e disbalancuar në dobi të njëres nga grupet.

Për shembull, kuotat mund të vendosen në administratën publike, në atë mënyrë që merret qëndrimi gjatë çdo avancimi në shërbim, nëse për funksion më të lartë aplikojnë mashkull dhe femër, me kualifikime të njëjta ose të ngjashme, përparësi do t'i jepet kandidatit femër.

Zakonisht kuotat vendosen në fusha ku gjatë kohë ka pasur situata të diskriminimit të një grupi të caktuar dhe janë të kufizuara në kohë dhe

funkcion. Kjo do të thotë se për momentin kur do të arrihet barazia ose do të krijohet atmosfera ku është zvogëluar ndikimi i diskriminimit që ka ekzistuar më parë, pushon të vlejë nevoja nga kuotat.

Për shembull: kuotat për pranim të privilegjuar për pranim të studentëve nga radhët e bashkësive etnike që nuk janë të përfaqësuar sa duhet, duhet të ndërpriten në momentin kur do të arrihet përfaqësim adekuat të këtyre studentëve në numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar në të gjitha universitetet në Republikën e Maqedonisë.

■ Ksenofobia

Frikë nga të huajt, nga çdo gjë që është e huaj, refuzim që individi e ndjen ndaj të huajit.

Në të vërtetë do të thotë sjellje e papranueshme shoqërore ndaj emigrantëve, punëtorëve stinor, kërkuesve të azilit, refugjatëve dhe familjeve të tyre.

A large, bold, black letter 'M' is centered on the page. It has a thick, uniform stroke and a simple, sans-serif design.

Masa afirmative (aksioni afirmativ)
Mendimi (si bazë për diskriminim)
Mosha (si bazë e diskriminimit)
Të mirat dhe shërbimet

■ Masa afirmative (aksioni afirmativ)

Aktivite të shtetit të cilat janë drejtuar drejt diskriminimit revers (kthyes). Manifestohet si reduktim, zvogëlim ose eliminim i pabarazisë faktike që ekziston për momentin, dhe e cila është krijuar si rezultat/pasojë nga diskriminimi i vazhdueshëm paraprak.

Kjo i nënkupton të gjitha aktivitetet të cilat i ndërmerr shteti, e të cilat janë drejtuar nga krijimi i kushteve për raste të barabarta të grupeve historikisht të diskriminuara dhe të marginalizuara, (pakica etnike, gra), gjegjësisht, dallime të shtresuara në dëm të grupeve të caktuara të njohura (fëmijët, njerëzve pa shtëpi etj.).

Qëllimi i parë i çdo aksioni afirmativ është zvogëlimi i debalancit në prezencën/dukshmërinë e pjesëtarëve të një grupi në jetën publike. Aksioni i tillë realizohet në krijimin e mundësive të veçanta (ekskluzive) për pjesëtarët e një grupi të caktuar në periudhë të caktuar kohore, ose, derisa është e nevojshme të korrigjohet diskriminimi paraprak ekzistues/i shtresuar.

57

Që dallimi të mund të llogaritet për legjitim, kjo duhet të definohet saktë dhe e kufizuar në kohë.

Aksioni afirmativ në mënyrë decime përmendet në Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor (neni 4) dhe në Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër gruas (neni 4).

Llojet e masave afirmative për shembull janë: vendosja e kuotave për grupet e caktuara në fushën e arsimit, marrëdhëniet e punës, veprimtaritë shërbyese (kreditë, beneficionet bankare etj.). Me sistemin e kuotave sigurohet numër i caktuar i vendeve, shërbimeve ose mjeteve, që të rezervohen për pjesëtarët e një grupi konkret të njerëzve. Shembull i aksionit afirmativ i këtij lloji është kur organet shtetërore ndërmarrin aktivitet për punësimin e një numri më të madh të pjesëtarëve të një grupi të caktuar të pakicave, ose kur përpiqen ta balancojnë strukturën gjinore të administratës me dhënien e preferencës aplikuesve të gjinisë femërore.

Diskriminimi në bazë të mendimit mund të manifestohet në krijimin e atmosferës kërcënuese dhe armiqësore, për të gjithë ata që kanë mendim tjetër nga shumica, dhe krijimi i sistemit ku ekzistojnë dallime të mendimeve “korrekte” politike (si e dëshiruar dhe të përmbajtur) dhe mendime “jo korrekte” politike (bartës të cilëve janë ekspozuar në forma të ndryshme të kufizimit të drejtave të tyre dhe lirive themelore).

■ Moshë (si bazë e diskriminimit)

Çdo veprim joligjor ose i paarsyeshëm ndaj njerëzve, i motivuar nga mosha e tyre (pa u mbajtur llogari për karakteristikat individuale të çdo individi). Moshë si bazë e diskriminimit mund të manifestohet lidhur me personat e moshuar dhe lidhur me të rinjtë. Edhe në rastin e parë edhe në rastin e dytë është e lidhur me ekzistimin e stereotipave dhe paragjyqimeve lidhur me moshën (e pleqërisë) e individëve.

Në identifikimin e moshës si bazë e mundshme e diskriminimit nisët nga qëndrimi se:

- Trajtimi i ndryshëm në bazë të moshës mund të llogaritet si diskriminim
- Kufijtë e moshës duhet të shqyrtohen me kujdes para se të definojnë në aktet ligjore dhe nënligjore
- Secili që vendos kufij moshe duhet të jap sqarime të qarta për nevojën nga kufijtë konkret
- Vështrimet për arsyeshmërinë e kufijve të moshës ndryshojnë dhe ato duhet të rishqyrtohen periodikisht

Moshë si bazë e diskriminimit mund të paraqitet në: sjelljen e përditshme, punë, arsim, gjatë blerjes (veçanërisht të pronës së patundshme), përdorimi i serviseve shërbyese, huazimit, aplikimi për kredi ose huazimi, puna me bankat dhe kompanitë e sigurimeve, marrja e shërbimeve nga shteti ose pushteti lokal, shërbimi shëndetësor.

Diskriminimi në bazë të moshës shpesh paraqitet në sferën e marrëdhënieve të punës, kur si kritere për punësim parashihet numër maksimal ose minimal i vjetëve (jashtë nga kufijtë e caktuar ligjor), ose

A large, bold, black letter 'N' is centered on the page. It is a simple, sans-serif font with a thick stroke.

Ngjyra e lëkurës (si bazë për diskriminim)
Normat restriktive
Nxitja e diskriminimit

■ Ngjyra e lëkurës (si bazë për diskriminim)

Nën ngjyrën e lëkurës nënkuptojmë pigmentimin e lëkurës së njeriut, e cila varet para së gjithash nga faktorët biologjik gjegjësisht gjenetik. Ajo mund të jetë më e çelur ose më e errët.


Diskriminimi në bazë të ngjyrës së lëkurës më shpesh paraqitet mes pjesëtarëve të grupeve të ndryshme racore, por megjithatë, “raca” si bazë e diskriminimit gjithnjë nuk mund ta përfshijë edhe “ngjyrën e lëkurës” si bazë. Kjo ka të bëjë për shkak të faktit që diskriminimi mund të kryhet edhe mbi pjesëtarët të cilët i përkasin racës së njëjtë, por dallohen sipas ngjyrës së lëkurës (qoftë të bëhet fjalë për ngjyrë më e errët ose më e çelur).

Shembull për diskriminim mbi bazë të ngjyrës së lëkurës është kur pjesëtarët e bashkësisë rome, të cilët kanë dukshëm ngjyrë më e errët të lëkurës nuk fitojnë trajtim të njëjtë në jetën e përditshme dhe veçanërisht gjatë ofrimit të një lloji të caktuar të shërbimeve (nuk u lejohet hyrja në restorant ose në pishinë, sjellja e punëtorëve në sportele në administratën shtetërore ose e policisë është e ndryshme etj.).

■ Normat restriktive

Masat me të cilat kufizohet, nuk mundësohet ose kushtëzohet veprimi i caktuar i lirë i individëve. Kur janë miratuar në kuadër të ligjit dhe kanë sqarim logjik, ato janë në funksion të mbrojtjes së njeriut. Në të kundërtën mund të paraqesin kufizime të paarsyeshme të drejtave dhe lirive të cilat shpesh kanë prapavijë diskriminuuese.

Për shembull: ndalesa e qasjes deri te shërbimet të një kategorie të caktuar të njerëzve (femra, meshkuj, vetmitarë) ose ndalesa e lëvizjes dhe shpërngulja në rajone të caktuara.



Organizata me interes legjitim
Orientimi seksual

■ Organizata me interes legjitim

Shoqatat e qytetarëve dhe organizatat tjera të cilat në mandatin e tyre parashohin luftë kundër diskriminimit dhe dhënien e ndihmës juridike ose tjetër viktimave të diskriminimit, llogaritet se kanë interesim legjitim të parashtrajnë në rendin e ditës, të jenë të involvuar ose të iniciojnë raste lidhur me diskriminimin.

Interes legjitim që në mënyrë aktive të inkuadrohen në rastet lidhur me diskriminimin kanë të gjitha organizatat lidhur me mbrojtjen e intereseve të anëtarëve të tyre kur janë të ekspozuar në diskriminim.

■ Orientimi seksual

Orientimi seksual d të thotë tërheqje emocionale ose fizike ndaj një personi tjetër, që zakonisht është e lidhur me gjininë e njerëzve të involvuar.

Orientimi seksual mund të manifestohet si:

- heteroseksuale (tërheqja mes pjesëtarëve të gjinive të ndryshme),
- homoseksuale (tërheqja mes dy meshkujve),
- lezbike (tërheqja mes dy femrave),
- biseksuale (tërheqja edhe ndaj gjinisë së vet edhe ndaj atij të kundërt).

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual ekziston kur një person trajtohet më eq (në legjisllacion ose praktikë) për shkak të orientimit seksual të atij personi (real ose i supozuar).

Një person mund të jetë i diskriminuar për shkak të orientimit të tij seksual në diapazon shumë të gjerë nga të drejtat dhe liritë (jeta private, lëvizja, të shprehurit, besimi, puna, avancimi në punë, arsimimi, pronësia, ilaçi efektiv, banimi etj.).

Për shembull, për diskriminimin në bazë të orientimit seksual mund të flitet kur çifti homoseksual nuk mund ta manifestojë dashurinë e vet në mënyrë të lirë, në mënyrë që është e zakonshme për çiftet homoseksuale. Ose, refuzimi i punëdhënësit të punësojë person me orientim homoseksual në vend të caktuar pune. Ose, personi me orientim homoseksual është i ekspozuar në shakaja të vazhdueshme dhe ofendime nga kolegët e tij.

Personat me orientim jo heteroseksual janë të ekspozuar në ofendime, keqtrajtime, përqeshje dhe refuzim. Shkelja e dinjitetit është një nga pasojat më të shpeshta të manifestimit publik të orientimit jo heteroseksual personal.

P

Pakicat etnike

Përkatësia ose përcaktimi politik (si bazë për diskriminim)

Paragjykimet

Person transgjinator

Punëtorja seksuale/punëtori seksual

Prejardhja sociale (statusi social me bazë për diskriminim)

Fjalori i shprehjeve lidhur me diskriminimin
përcakatëthike përkatesia ose përcaktimi politik (si bazë për diskriminim)
paragjykimet Personi transgjinor Punitëria seksuale (punitësi) seksual
preardhja sociale (statusi social) me bazë për diskriminim) Përcatëthike
përkatesia ose përcaktimi politik (si bazë për diskriminim) Paragjykimet
(personi transgjinor) Punitëoria seksuale (punitësi) seksual Preardhja sociale
(statusi social) me bazë për diskriminim) Përcatëthike përkatesia ose përcaktimi
politik (si bazë për diskriminim) Paragjykimet Personi transgjinor Punitëoria
seksuale/punitëoria seksuale Preardhja sociale (statusi social) me bazë për



■ Pakicat etnike

Pakicat etnike të cilat me numër janë më pak të përfaqësuar se sa nga ndonjë bashkësi dominonte etnike në territorin e shtetit konkret, pavarësisht nga ajo nëse kanë ose nuk kanë shtet amë, ku ata vetë paraqiten si bashkësi dominonte (shumicë).

■ Përkatësia ose përcaktimi politik (si bazë për diskriminim)

Përkatësi ose jo përkatësi në ndonjë grupim politik, shprehja e qëndrimit politik ose manifestimi i përkatësisë, gjegjësisht, refuzimi i ideologjisë politike. Përkatësia politike si bazë e diskriminimit ka të bëjë edhe me rastet kur një person i caktuar nuk ka përkatësi konkrete politike.

Si bazë e diskriminimit e pranon edhe mendimin politik lidhur me politikën konkrete të strukturave në pushtet dhe lidhur me çështje të cilat e prekin mënyrën e sundimit në shtet.

Diskriminimi në bazë të përkatësisë ose përcaktimit politik, për shembull, ekziston në rastin kur një nëpunës shtetëror është degraduar pavarësisht nga cilësitë e tij dhe aftësitë profesionale pasi që ka përcaktim tjetër politik nga struktura aktuale në pushtet. Diskriminimi ekziston edhe në rast kur pjesëtarët e një partie të caktuar politike vështirë vjen deri te shërbimet publike, kanë më shumë probleme gjatë marrjes së lejeve për qëllime të ndryshme ose janë të ekspozuar në kontrolle të posaçme dhe të shpeshta.

Mendimi politik si bazë e diskriminimit mund të mos jetë e lidhur me politikën publike të qeverisë ose shtetit konkret. Në situata të tilla, shumë shpesh do të paraqitet vështirësia që të kufizohet nëse një mendim është politik ose jo.

Për shembull, anëtar i sindikatës mund të thotë se ka qenë i diskriminuar në bazë të mendimit politik për shkak të aktiviteteve të tija në sindikatë.

Kjo është për shkak të faktit se aktivitetet e sindikatës janë të lidhura me politika dhe qëndrime të qeverisë në rregullimin e marrëdhënieve të punës. Në rastin e tillë, punëdhënësi do të pohonte se aktivitetet e punëtorit janë të lidhura me çështjen e vendit dhe obligimeve të punës, e jo me politikat më të gjera të Qeverisë.

■ Paragjykimet

Qëndrime për njerëzit, objektet dhe dukuritë të cilat nuk kanë bazë logjike, mbahen në vazhdimësi, të përcjella me emocione të fuqishme dhe shkaktojnë veprime/sjellje të caktuara që për pasojë kanë trajtim të pavolitshëm të një kategorie konkrete njerëzish në raport me tjetrën.

Paragjykimet formohen pa ekzistimin e diturisë ose hulumtimit paraprak të fakteve. Ato mbështeten në supozime, ndjenja dhe besime. Merret vendimi (zgjidhja) pa u qenë i vetëdijshëm për faktet dhe rrethanat relevante.

72

Për shembull, qëndrimi se njeriu i cili është i infektuar me HIV nuk mund të punojë paraqet paragjykim. Ose, se homoseksualët janë pedofilë. Ose, deklarata se të gjithë hebrenjtë janë të pasur.

Paragjykimet shpijnë drejt diskriminimit (në raste të caktuara kjo do të thotë se: personi nuk pranohet në punë, homoseksualët pengohen të punojnë në institucione arsimore, hebrenjve nuk ju jepet ndihmë sociale).

■ Person transgjignor

Person i cili është ose dëshiron të jetë i perceptuar ose ka kryer ose është procesin e kryerjes së intervenimit mjekësor që të bëhet pjesëtar i gjinisë së kundërt.

Këta persona mund të kenë karakteristika të cilat zakonisht lidhen me njëjën nga gjinitë, me të cilën ata identifikohen ose i kanë karakteristikat e ty gjinive.

Identiteti gjinor nuk guxon të përziehet me orientimin seksual. Personat transgjinor mund ta kenë varietetin e njëjtë të orientimit seksual dhe personat e definuar gjinor.

Personat transgjinor janë të ekspozuar në diskriminim në të gjitha fushat e jetës publike dhe private dhe janë objekt i urrejtjes dhe sjelljes së dhunshme. Personi transgjinor duhet të trajtohet në pajtim me preferencën e tij personale.

■ Punëtorja seksuale/punëtori seksual

Person i cili me vullnetin e vet merret me dhënien e shërbimeve seksuale, si burim i mjeteve për jetë.

Puna seksuale është burim i diskriminimit në të gjitha sferat e jetës publike dhe private, nga ana e personave privat dhe nga ana e përfaqësuesve të pushtetit.

Diskriminimi i zakonshëm ka të bëjë vetëm me ofruesit, e jo edhe me shfrytëzuesit e shërbimeve.

Diskriminimi mund të manifestohet në dhënien e ndihmës nga ana e policisë gjatë një sulmi seksual ose tjetër, ose refuzimi të merret me qira ose të shitet banesa, poshtërim dhe sjellja jo e barabartë e punëtorëve në veprimtaritë shërbyese (kamerierë, punëtorët në sportele, punëtorët social).


■ Prejardhja sociale (statusi social me bazë për diskriminim)

Renditja e njerëzve dhe vendosja e hierarkisë joformale dhe formale, ku disa kanë pozitë të privilegjuar, ndërsa të tjerët nuk kanë, në bazë të përkatësisë së personit të caktuar të ndonjë grupi shoqëror ose klase në shoqëri, gjegjësisht, përkatësia e paraardhësve të tij në po atë grup. Vetëm me faktin e lindjes nga paraardhësit të cilët i takojnë grupit konkret edhe fëmija e fiton statusin e njëjtë, do të thotë e trashëgon.

P

Përkatësia ndaj grupit të renditur konkret shoqëror mund të ketë pasoja: ndalesa për t'u martuar me pjesëtar të një grupi tjetër shoqëror, segregacioni dhe getoizimi, qasja e kufizuar ndaj objekteve shërbyese publike (shkolla, vende për rituale fetare dhe qasja deri te burimet publike të ushqimit dhe ujit).

Përkatësia ndaj grupit të renditur konkret shoqëror mund të ketë pasoja: ndalesa për t'u martuar me pjesëtar të një grupi tjetër shoqëror, segregacioni dhe getoizimi, qasja e kufizuar ndaj objekteve shërbyese publike (shkolla, vende për rituale fetare dhe qasja deri te burimet publike të ushqimit dhe ujit).

A large, bold, black letter 'Q' is centered on the page. The letter is a simple, sans-serif font with a thick stroke. The tail of the letter curves downwards and to the right.

Qëllimi legjitim (objektivisht i arsyetuar)
Qëllimi (ekzistimi ose mosekzistimi)

■ Qëllimi legjitim (objektivisht i arsyetuar)

Qëllim i cili nuk është në kundërshtim me Kushtetutën dhe dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare, e që korrespondon me nevojat reale, nga më parë është saktë e definuar dhe është proporcionale me efektet cilat duhet të arrihen.

Shembuj të qëllimit legjitim mund të jenë: kërkesa për një lloj të caktuar të arsimit gjatë aplikimit për vend konkret pune ose avancim në karrierë (fakulteti i mjekësisë për punësim si mjek i përgjithshëm, specializim për punë si gjinekolog), trajnim i kaluar pse posedimi i shkathëtsive konkrete (trajnimi për punësim në polici), nevoja nga përvojë e posaçme (për vende udhëheqëse), karakteristika shëndetësore dhe fizike (për punë në minierë ose punë si zjarrfikës).

Ekzistimi i qëllimit legjitim objektivisht të arsyetuar, shpie drejt përjashtimit nga diskriminimi. Kjo do të thotë se, në raste të caktuara, veprimi ndryshe, dallimi ose përjashtimi të cilat bazohen në njërin nga bazat e mundshme të diskriminimit, nuk llogariten për diskriminim.

Në këtë kuptim nuk do të llogariten si diskriminuese kërkesat e veçanta dhe kushtet për punësim ose kryerjen e aktiviteteve të caktuara, kur ato kërkesa dhe kushte janë të domosdoshme për kryerjen adekuate të aktivitetit të dhënë, gjegjësisht, paraqesin element thelbësor të një aktiviteti të caktuar pune.

Për shembull, nuk do të llogaritet për akt të diskriminimit parashtrimi i kushteve lidhur me: paaftësinë afariste, kufirin e lartë të pensionit sipas moshës, nevoja nga kualifikime dhe shkathtësi të veçanta, ndalesat ligjore ose ndalesat e shqiptuara në aktgjykimin lidhur me kryerjen e veprimtarive të veçanta (arsimi, policia, drejtimi me automjet), kufizime të përkohshme, masat të cilat ndërmerren për shkak të mbrojtjes së popullatës etj.

Situatë ku karakteristikat të cilat janë lidhur me ndonjë nga bazat e diskriminimit nuk do të lidhen me veprimin joadekuat dhe nuk do të lidhen me diskriminimin, për shkak të natyrës së punës konkrete, nënkupton insistim të karakteristikave specifike si kërkesë thelbësore dhe përcaktuese për kryerjen e asaj pune.

Që të bëhet fjalë për kërkesë thelbësore dhe përcaktuese, qëllimi duhet të jetë legjitim dhe kërkesa të jetë adekuate ndaj natyrës së atij profesioni dhe kushtet ku kryhet. Dallimi në trajtimin e bazuar në ekzistimin e qëllimit legjitim dhe objektivisht të arsyetuar mund të jetë i arsyeshëm vetëm në kushte tepër legjitime të cilat duhet të definojnë saktë.

Arsyeshmëria (domosdoshmëria) i qëllimit dhe mungesa e alternativës racionale, duhet të dëshmohej dhe të jetë e dëshmuar në çdo rast individual nga ana e atij që i përcakton kushtet, me të cilat njerëzit trajtohen ndryshe në situatën e njëjtë. Duhet të dëshmohej se ekziston nevojë e tillë, se praktikizmi i trajtimit të ndryshëm është i domosdoshëm për plotësimin e asaj nevojë, nuk mund të zgjidhet problemi me asgjë tjetër përveç me diskriminim.

Për shembull: objektivisht është e arsyeshme për vende të caktuara pune që të kërkohet përgatitje e veçantë fizike (pilot i aeroplanit, kozmonaut), ose kualifikime të veçanta dhe përvojë paraprake (kirurg, prokuror publik). Nuk do të merret për diskriminim kërkesa që rojet në burgun e grave të jenë gra, ndërsa në burgun për meshkuj, të jenë meshkuj, e as, kërkesa për kufirin e lartë për realizimin e të drejtës për pension.

■ Qëllimi (ekzistimi ose mosekzistimi)

Çdo veprim (ose mosveprim) pavarësisht nga ajo nëse personi ose organi që vepron kanë qëllim qartë të definuar që të diskriminojnë, gjegjësisht, pavarësisht nga ajo nëse diskriminimi është rezultat i dëshiruar nga më parë. Kjo e përfshinë edhe çdo veprim të pakujdesshëm.

Për shembull: shpallja e rregullave për shfrytëzimin e një objekti të caktuar publik, të cilat mund të shfrytëzohen për diskriminimin e një kategorie konkrete të njerëzve, që vetë për vete paraqet akt të diskriminimit pavarësisht nga ajo nëse ai që i ka vendosur rregullat ka pasur ose jo qëllim të diskriminojë kategori konkrete njerëzish.

Mosekzistimi i qëllimit shpesh herë mund të lidhet me diskriminimin e drejtpërdrejtë.

R

Raca (si bazë e diskriminimit)
Ratifikimi
Religjioni (si bazë për diskriminim)

■ Raca (si bazë e diskriminimit)

Koncept i ndarjeve të njerëzve në grupe në bazë të karakteristikave të dukshme (të jashtme) fizike (ngjyra e lëkurës, flokëve, forma e syve, struktura e fytyrës). Zakonisht ka të bëjë me grupe njerëzish të cilët ekzistojnë në hapësirë të caktuar gjeografike, dhe dallohen nga të tjerët për shkak të disa karakteristikave të cilat përcillen gjenetikiisht.

Vetë koncepti paraqet konstrukt shoqëror (besim i krijuar nga ana e njerëzve) i cili i grupon njerëzit në bazë të karakteristikave të tyre të supozuara fizike dhe kulturore. Vetë koncepti ka vlerë, rëndësi dhe përdorim tjetër në nivele të ndryshme të zhvillimit të njeriut.

Hulumtimet më të reja e mohojnë ekzistimin e grupeve të ndryshme biogjenetike të njerëzve.

Diskriminimi racor është një nga llojet më të vjetra dhe më të përhapura të diskriminimit. Karakteristikat e jashtme dalluese mundësojnë zhvillimin e paragjytimeve ndaj një numri të madh ët njerëzve, të cilët njihen si pjesë e një grupi të caktuar racor dhe trajtim jo i njëjtë ndaj njerëzve të bazuar në këtë lloj të dallimit.

Diskriminimi racor manifestohet si racizëm – vështrim ndaj botës dhe sjellje që bazohet në ndarjen e njerëzve në raca, të cilat gjenetikiisht dallohen në inteligjencë, krijimtari, qëndrueshmëri etj., për çka nuk mund të kenë të drejta të njëjta dhe qasje të njëjtë ndaj resurseve shoqërore dhe pasurive.

Sipas “Deklaratës për raca dhe paragjykimet racore” të gjithë njerëzit i takojnë ndonjë race dhe kanë prejardhje të përbashkët, dhe të gjithë duhet të kenë mundësi të njëjta për arritjen e shkallës më të lartë të zhvillimit intelektual, social, ekonomik, kulturor dhe politik. Për këtë shkak, llogaritet se problemet lidhur me “racën” si nocion kanë gjenezë sociale. Shpesh nocioni racë është përdorur me qëllim që të ndahen njerëzit në shoqëri në grupe, me qëllim që pjesëtarët e një grupi të llogariten si të aftë dhe superior në krahasim me pjesëtarët e grupit tjetër.

R

Racës i është dhënë rëndësi e madhe në legjislacion, ndalesës së diskriminimit pikërisht për shkak të ekzistimit të diskriminimit lidhur me “racën”. Shumë instrumente për të drejtat e njeriut (nga vendi dhe ndërkombëtare) e parashohin racën si bazë të veçantë me të cilën ndalohet diskriminimi. Dhe të shmangen të gjitha dilemat e mundshme për atë çfarë do të thotë raca, ndalesa e diskriminimit në bazë të racës në vete përfshinë më shumë baza. Kështu, në Konventën ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, si diskriminim racor llogaritet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose privilegjim që bazohet në racën, ngjyrën e lëkurës, prejardhjen (paraardhësit), prejardhja nacionale ose etnike.

Në një numër të caktuar shtetesh është pranuar modeli sipas të cilit nuk përmendet ekzistimi i racave. Për shembull, në Aktin jo diskriminues finlandez përmendet vetëm “prejardhja etnike dhe nacionale”, ndërsa “Akti për diskriminim etnike” në Suedi e përmend “përkatësinë etnike”.

82 ■ Ratifikimi

Akt i pranimit të një dokumenti të caktuar ndërkombëtar në legjislacionin kombëtar. Zhvillohet nëpër procesin që është i njëjtë me procesin e miratimit të ligjeve kombëtare.

Në Republikën e Maqedonisë ratifikimin mund ta bëjë Kuvendi në procedurë të njëjtë si gjatë miratimit të ligjeve dhe përfundon me shpalljen në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

■ Religjioni (si bazë për diskriminim)

Besimi në ekzistimin e fuqisë/ve mbi njeriun, të cilat ndikojnë dhe e drejtojnë fatin e tij. Religjioni mund të manifestohet në sistem të kodifikuar nga besimi dhe praktika, rituale të caktuara, tradita, mitologji specifike dhe qëndrime personale.

Për religjionin si bazë e mundshme për diskriminim nuk është e rëndësishme nëse religjioni është i institucionalizuar ose i lidhur me besimin e një individi dhe raportin e tij ndaj botës.

Diskriminimi për shkak të bindjes religjioze mund të manifestohet në veprimin ose jo veprimin me të cilin janë prekur vetëm personi ose personat të cilët i takojnë një feje të caktuar.


Për shembull, për shkak të sigurisë së fluturimeve, në aeroporte merren masa të sigurisë vetëm ndaj pjesëtarëve të një religjioni (islam). Ose kur një pjesëtar i religjionit pakicë nuk i lejohet qasje në transportin publik ose në vendet publike, ose i jepet pagë më e ulët etj.

Diskriminimi për shkak të bindjes religjioze mund të jetë edhe i drejtpërdrejtë (kur aplikohen rregulla të njëjta lidhur me personat me bindje të ndryshme religjioze) dhe kjo shkakton mundësi të ndryshme për praktikumin e të drejtave dhe lirive.

Për shembull, ndalesa për mbajtjen e shamive në objektin e fakultetit.

Formë e veçantë e diskriminimit mund të manifestohet në kultivimin e raportit të ndryshëm (të privilegjuar) ndaj pjesëtarëve të religjionit dominues në një shtet të caktuar.

Për shembull: ndërtimi i objekteve fetare me mjete nga shteti vetëm për nevojat e një religjioni, lehtësimi gjatë marrjes së lejeve të ndërtimit, prezenca më e madhe pa pagesë në medime etj.



RR

85

Rrethimi arkitektonik

■ Rrethimi arkitektonik

Të gjitha godinat, objektet dhe pjesë nga objekte me karakter publik, të cilat i kanë në dispozicion njerëzit për shfrytëzim ose që janë lidhur me plotësimin e nevojave të veçanta, ose me marrjen e shërbimeve të caktuara.

Për shembull, këtu i përfshinë: rrugët, trotualet, parqet, teatrot, sallat e kinemave, shkollat, fakultetet, shitoret, hotelet, restorantet, pishinat etj. Në kuptimin më të gjerë të rrethimit arkitektonik përfshihen edhe mjetet e transportit publik (trenat, autobusët, tramvajet, trolejbusët). Mjetet e transportit publik mund të jenë të arritshme/jo të arritshme në procesin e hipjes, qëndrimit në ato, si dhe nga aspekti i numrit të tyre, prezencën e mjaftueshme në rrugë.

S

Statusi pronor (si bazë e diskriminimit)
Sektori publik
Statusi personal (si bazë e diskriminimit)
Statusi shoqëror (si bazë për diskriminim)
Segregacioni
Stereotipat
Stigma

■ Statusi pronor (si bazë e diskriminimit)

Statusi pronor e paraqet fuqinë pronore të një individi, gjegjësisht, të familjes ku lind ose cilës i takon (me të cilën identifikohet). Zakonisht manifestohet si bazë për diskriminim të personave me status më të ulët pronor.

Mund të manifestohet në të gjitha segmentet nga jeta publike, e veçanërisht në: arsim, mbrojtjen shëndetësore, legjislacion, veprimtaritë shërbyese.

Për shkak të zvogëlimit të diskriminimit mbi bazë të statusit pronor shtetet garantojnë disa shërbime themelore për të gjithë qytetarët (gjegjësisht, disa shërbime ofrohen pa pagesë ose me kompensim minimal). I tillë është rasti me ndihmën juridike pa pagesë, shërbimet shëndetësore pa pagesë, arsimi pa pagesë ose ofrimi i bursave të bazuara në nevoja etj.

■ Sektori publik

Një pjesë nga jeta ekonomike dhe administrative që merret me distribuimin e të mirave dhe serviseve nga dhe për shtetin, gjegjësisht që gjendet nën mbikëqyrjen e pushtetit qendror, rajonal ose lokal (për shembull: mbrojtja sociale, planifikimi urbanistik, mbrojtja nacionale).

■ Statusi personal (si bazë e diskriminimit)

Çdo dallim që vjen nga karakteristikat personale të një njeriu konkret lidhur me: pamjen e jashtme (fizike) dhe/ose karakteristikat, si dhe me pozitën e ose në familje, pozitën e bashkëshortit ose të ndonjë familjari lidhur ngushtë me personin për të cilin bëhet fjalë.

Statusi personal është i lidhur me prejardhjen, ose me ndonjë identifikim tjetër shoqëror të vendit të individit të caktuar për shkak të ndonjë karakteristike të tij ose lidhje farefisnore me njerëzit me karakteristika të caktuara.

Diskriminimi në bazë të statusit personal shpesh fshihet pas moralit, traditës ose veprimit të zakonshëm.

Për shembull: marrëdhëniet me palët dhe gatishmëria e punëtorëve në sportele të depriviligjojnë palët të caktuar për shkak se është veshur me rroba të vjetra dhe të përlyera, për shkak se ka prejardhje nga familje e varfër, pse e ka mbajtur dënimin me burg, përkundër veprimit të privilegjuar ndaj njerëzve të cilët janë bukur të veshur, të cilët i takojnë një profesioni konkret etj.

■ Statusi shoqëror (si bazë për diskriminim)

Vendi ku një individ ose grup e merr me rolin e tij që e ka në bashkësi. Është i ndërlidhur me profesione të caktuara (nga njëra anë profesione të cilat gëzojnë respekt të veçantë në bashkësi, përkundër profesioneve të cilat janë nënvlerësuar), pozita në shkallën e karrierës (tradicionalisht të perceptuara si të rëndësishme dhe të dëshiruara, përkundër titujve më të ulët), shkathtësi të veçanta, pozita momentale ose e vazhdueshme në bashkësinë shoqërore (deputet, kryetar komune, këshilltar, drejtor, përkundër qytetarëve “të zakonshëm”). Një individ ose grup i njëjtë mund të jetë bartës njëkohësisht i statusit të ndryshëm shoqëror (ose në perioda të ndryshme kohore).

Për shembull: një njeri mund të ketë status të lartë shoqëror sepse është profesor në fakultet dhe të ketë status të ulët shoqëror sepse nuk pajtohet me qëndrimet e garniturës në pushtet ose i takon bashkësisë së marginalizuar etnike.

Statusi shoqëror mund të jetë i lidhur edhe me vendbanimin ose vendin e prejardhjes.

Diskriminimi në bazë të statusit shoqëror mund të manifestohet në qasjen më të madhe (të rëndomtë) të resurseve të caktuara varësisht

nga statusi i individit (mjekët më lehtë mund të arrijnë deri te ilaçet, pjesëtarët e një partie të caktuar politike më lehtë caktojnë bisedë të funksionarët shtetëror, policët nuk i regjistrojnë shkeljet më të vogla të kolegëve të tyre...).

■ Segregacioni

Sistem i masave dhe veprime represive me të cilat pengohet, promovohet ose vështirësohet përzjerja e njerëzve, të cilët perceptohen si pjesëtarë të grupeve të ndryshme.

Segregacioni mund të bëhet mbi baza të ndryshme (etnike, kulturore, religjioze dhe gjinore).

Akti i segregacionit ekziston pavarësisht nga ajo nëse bëhet nga ana e shtetit ose organeve tjera, personave privat ose strukturave me karakter publik (për shembull: shkuarja në restorant, shkuarja në shkollë, spitale, kinemaja, teatro dhe objekte tjera, marrja me qira e banesave dhe patundshmërive etj.) dhe pavarësisht nga ajo nëse është e definuar me ligj ose është pjesë e sjelljes tradicionale shoqërore.

Për shembull: si akt i segregacionit mund të llogaritet ndarja e fëmijëve me përkatësi të ndryshme etnike në shkolla të veçanta, fakultete. Ose, ekzistimi i orëve të veçanta për vizitë në objektet sportive për meshkuj dhe femra. Ose, përqendrimi i dhunshëm i popullatës nga një përcaktim i caktuar religjioz në një pjesë të vendbanimit.

Për segregacionin bëhet fjalë pavarësisht nga ajo se kush e inicion dhe e zbaton ndarjen (grupi i pakicës ose shumicës).

■ Stereotipat

Kuptime relativisht të thjeshta dhe rigide për karakteristikat e pjesëtarëve të një grupi të caktuar ose kategori njerëzish. Stereotipa janë përjashtuese dhe nuk e reflektojnë realitetin. Stereotipat mund të jenë edhe negative edhe pozitive, bazohen në informata shumë të pajta dhe janë shumë rezistuese ndaj ndryshmeve.

Stereotipat kanë të bëjnë me: gjininë (për shembull: femrat janë vizitës shumë të dobët, femrat janë më emocionale se meshkujt, femrat më shumë flasin se meshkujt), racore (pjesëtarët e racës së zezë janë më të mirë në sport, ndërsa pjesëtarët e racës së bardhë janë më krijues), përkatësia etnike (vllahët janë koprrac), përkatësia religjioze (pjesëtarët e fesë islame janë agresiv), profesione të caktuara (policët nuk janë inteligjent) ose karakteristika fizike (biondinat janë më pak të mençura se ato me ngjyrë të errët të flokëve).

Stereotipat paraqesin bazë të paragjytimeve, por edhe vetë mund të jenë bazë për diskriminim dhe sjellja e ndryshme ndaj njerëzve të bazuar në përkatësinë e tyre ndaj një kategorie të caktuar njerëzish.

Si të diskriminuar më shpesh paraqiten: emigrantët (pa dallim të shkaqeve për shkak të cilave e ka braktisur shtetin amë), refugjatët, kërkuesit e azilit, por edhe çdo qytetar që nuk është shtetas i shtetit konkret në rrethana të caktuara.

Diskriminimi mund të jetë pjesë e dispozitave ligjore ose në sjelljen praktike të organeve shtetërore, gjegjësisht të individëve.

■ Stigma

Stigma është veçori e padëshiruar ose diskredituese e cila i shtohet personit ose një grupi të orientuar drejt uljes së statusit të këtij personi ose grupit në sytë e bashkësisë.

Stigma bazohet në besimin dhe paraqet vegël të fuqishme të kontrollit shoqëror. Stigma mund të përdoret që të marginalizojë, të përjashtojë dhe të praktikojë fuqi mbi individët, të cilët kanë ose u jepen karakteristika të caktuara.

Viktima më të shpeshta të stigmatizimit janë personat të infektuar me HIV ose të sëmurët nga AIDS, punëtorët seksuale, personat me orientim jo heteroseksual, njerëz të cilët injektojnë drogë.

SH

Shqetësimi
Shtetësia
Shëndeti (si bazë e diskriminimit)
Shërbimet publike (shërbimet dhe serviset tjera)
Shqetësimi seksual

■ Shqetësimi

Çdo sjellje e padëshiruar lidhur me ndonjërin nga bazat e diskriminimit, pavarësisht nga ajo nëse manifestohet në mënyrë fizike, verbale ose tjetër, që është e drejtuar ose ka për qëllim, shkeljen e dinjitetit të një personi të caktuar ose krijimin e mjedisit, qasjes ose praktikës kërcënuese, armiqësore, degraduese, ofenduese ose frikësuese.

Shqetësimi nënkupton aktivitete negative, joadekuate, të cilat kanë për qëllim të kontrollojnë, frikësojnë ose t'i përjashtojnë individët.

Shqetësimi mund të manifestohet në:

- të folurit, sjellja ose aktivitete në vazhdimësi, që janë drejtuar nga ndonjë individ, e të cilat i bëjnë presion, e irritojnë, të cilat janë kërcënuese ose shkaktojnë stres të dukshëm emocional;
- komente të padëshiruara (për pamjen, për karakteristika të caktuara ose për veprime konkrete të ndonjë individi);
- gjeste poshtëruese, ofenduese, qëllimkeqe, degraduese ose kërcënuese, pavarësisht nga ajo nëse bëhet fjalë për aktivitet që përsëritet ose ka ndodhur rastësisht, por që nuk është e rëndësishme sa duhet që të ndikojë mbi prezantimin, kontributin ose rrethimin ku punon të dikujt.

97

Quid pro quo shqetësimi paraqet shqetësim seksual ku kërkesa që të plotësohet një kërkesë e caktuar seksuale (mbledhje, shërbim seksual, mundësimi i një intimiteti të caktuar) përdoret si bazë (kusht) për punësim dhe/ose avancim në karrierë, si kusht për sjelljen e një zgjidhje konkrete akademike (notë për provimin e dhënë, kolokuium, punë seminare ose ndonjë tjetër), fitimi i shërbimit adekuat ose ngjashëm.

■ Shtetësia

E përcakton lidhjen juridike mes individit dhe shtetit konkret. Këtë status çdo shtet e rregullon me legjislacion të veçantë dhe marrja e tij është e lidhur me plotësimin e kushteve të caktuara (të cilat i definon vetë shteti).

Me marrjen e nënshtetësisë individi fiton të drejta të caktuara (të votojë, të zgjidhet/ në vende udhëheqëse në shtet, të marrë ndihmë adekuate sociale) dhe obligime (pagesa e tatimeve të caktuara) të cilat nuk i kanë ata që nuk janë nënshtetas të një shteti konkret. Disa shtete lejojnë ekzistimin e dyshtetësisë (gjegjësisht lejojnë shtetasi i tyre në të njëjtën kohë të jetë edhe shtetas i një shteti tjetër).

Individi është apatrid atëherë kur nuk ka asnjë nënshtetësi. Individi mund të mos ketë nënshtetësi sepse nuk ka fituar nënshtetësi gjatë lindjes, është gjendur në rrethana të jashtëzakonshme ku e ka humbur nënshtetësinë më parë të fituar (luftë, ndjekje, ndryshimi i kufijve shtetëror), ose vetë ka hequr dorë nga nënshtetësia e në shteti konkret.

98

Secili ka të drejtë për nënshtetësi dhe askush arbitrarisht nuk mund të privohet nga nënshtetësia ose t'i ndalohet ndërrimi i nënshtetësisë. E drejta e nënshtetësisë i garantohet çdo fëmije në Paktin Ndërkombëtar për të Drejta Qytetare dhe Politike dhe vërtetohet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventën Evropiane për Nënshtetësi.

Diskriminimi mbi bazë të këtij mund të ketë lidhje me raportin specifik të shtetit ndaj shtetasve të shteteve të caktuara, kufizimi i të drejtave të caktuara për shkak të mospasjes së nënshtetësisë ose për shkak të mospasjes së nënshtetësisë konkrete. Shpesh manifestohet në: pabarazi para ligjit, mbrojtje jo e barabartë gjyqësore ose tjetër, dhe në trajtim jo të barabartë lidhur me të drejtat sociale dhe kulturore. Diskriminimi mbi bazë të nënshtetësisë shpesh lidhet me ksenofobinë.

■ Shëndeti (si bazë e diskriminimit)

Nën shëndet nënkuptohet gjendja e funksionimit të përgjithshëm fizik, mendor, shoqëror dhe shpirtëror të një individi të caktuar (qoftë që bëhet fjalë për gjendjen faktike ose për gjendjen ku vetë individi ose të tjerët e perceptojnë).

Shëndeti paraqet bazë për diskriminim ku për shkak të nivelit të caktuar të funksionimit fizik, mendor, shoqëror dhe shpirtëror individi pa arsye trajtohet në mënyrë të pavolitshme në cilindo segment nga jeta. Diskriminimi në bazë të shëndetit shpesh manifestohet në procesin e punësimit, por mund të manifestohet edhe në cilëndo fushë (marrja e një lloji të caktuar të shërbimeve, bankieri, shërbime nga kompanitë e sigurimeve, marrja me qira ose blerja e banesave, liria e lëvizjes).

Forma të shpeshta të diskriminimit sipas kësaj baze janë ato kur individi ka sëmundje të rëndë si për shembull: hepatit C, i varur nga droga, AIDS (ose i infektuar me HIV).

Shembuj të praktikave diskriminuese do të ishin: kërkesa e HIV testimit të domosdoshëm si kusht për punësim; përjashtimi nga procedura për punësim për shkak të gjendjes shëndetësore që nuk është e lidhur me kërkesat e vendit të dhënë të punës; marrja e njoftimit për pushim nga vendi i punës ose presioni për dhënien e pushimit nga puna për shkak të gjendjes shëndetësore, që nuk është e lidhur me nevojat e vendit të caktuar të punës; trajtimi joadekuat nga ana e mjekut ndaj personave që varen nga droga (refuzimi të jepen shërbimet mjekësore, trajtimi joadekuat, terapi joadekuate).

Diskriminimi mund të paraqitet qoftë nëse bëhet fjalë për gjendje aktuale me shëndetin, nëse bëhet fjalë për gjendjen që ka ekzistuar në të kaluarën, dhe për të cilën supozohet se ka ose mund të ndikojë për momentin.

Për shembull: si akt i diskriminimit mund të llogaritet akti i largimit nga puna i një gruaje sepse ka kancer në gj (me arsyetimin se nuk do të mund t'i kryejë obligimet e punës), por edhe largimi nga puna i gruas e cila më herët ka pasur trajtim ndaj kësaj sëmundje (me arsyetimin

se i nevojitet kujdes i vazhduar, se fizikisht nuk është e fortë, se do t'i nevojiten ditë të lira për ekzaminime të rregullta mjekësore etj.).

Diskriminimi në bazë të shëndetit dallohet nga diskriminimi i cili për bazë e ka invaliditetin.

■ Shërbimet publike (shërbimet dhe serviset tjera)

Nën shërbime publike nënkuptohen të gjitha shërbimet dhe serviset që bëhen për interes të përgjithshëm, ofrohen profesionalisht nga cilindo organ, organizatë ose institucion privat ose shtetëror, gjegjësisht ofrohen nga organ i caktuar ose institucion shtetëror. Shërbimet mund të ofrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë mes organeve shtetërore ose nëpërmjet strukturave private të zgjedhura për atë qëllim.

100

Shërbimet publike përbëhen nga qasja deri te dhe përdorimi i objekteve dhe pjesëve nga objektet, në cilindo vend publik ose mjet transporti publik, të cilat janë paguar nga qytetarët ose për të cilat qytetarët paguajnë veçmas, e të cilat i kanë në dispozicion qytetarët.

Më së shpeshti në shërbimet publike marrin pjesë: bankieri, sigurimi, kreditimi, huazimi ose financimi, mbrojtja shëndetësore dhe realizimi i të drejtave të mbrojtjes shëndetësore, dhënia e ndihmës juridike ose realizimi i të drejtës së ilaçit efektiv, pushimi, rekreacioni dhe argëtimi, transporti ose udhëtimi.

Termi shërbime publike është i lidhur me konsensusin e arritur civilizues se shërbime të caktuara duhet të jenë të kapshme për qytetarët pavarësisht nga të ardhurat e tyre. Bile edhe atje ku shërbimet publike nuk janë financuar nga ana e shtetit (siç janë: qendrat private për punë sociale, agjencitë private për punësim, ndërmarrjet komunale private) ato rregullohen nga ana e shtetit dhe i nënshtrohen kërkesave dhe kufizimeve të veçanta.

Diskriminimi i lidhur me shërbimet publike ka të bëjë me prezencën e tyre sasiore (në rajone ose mjedise të caktuara gjeografike), në mënyrën

se si jepen shërbimet, në kapshmërinë e shërbimeve për grupe të ndryshme të qytetarëve, si dhe në barazinë e cilësisë së shërbimeve.

Për shembull: nëse ndërmarrja komunale dukshëm dërgon numër të vogël të automjeteve për grumbullimin e llojeve në lagje të caktuara ku jetojnë numër i madh i romëve, bëhet fjalë për diskriminim. Ose, nëse për marrjen e dokumenteve të caktuara banorët e fshatrave duhet të kenë shpenzime më të mëdha (transport, mungesë nga puna etj.), atëherë bëhet fjalë për diskriminim.

■ Shqetësimi seksual

Lloji i diskriminimit që karakterizohet me sjellje të padëshiruar me karakter seksual, që manifestohet në mënyrë fizike, verbal ose tjetër, ndërsa ka për qëllim të shkaktojë shkeljen e dinjitetit të personit dhe/ose të krijojë armiqësi, rrethim kërcënues dhe poshtërues, veçanërisht kur refuzimi të pranohet sjellja e tillë, ose presioni që të pranohet, mund të ndikojë në miratimin e vendimeve të cilat do të kenë ndikim ndaj atij personi.

101

Shqetësimi seksual mund të paraqitet në kushte të ndryshme:

- Viktima ose kryesi i veprës mund të jetë mashkull ose femër.
- Viktima mund të mos jetë i gjinisë së kundërt.
- Kryesi i veprës mund të jetë i avancuar në raport me viktimën në kuadër të organizatës së njëjtë, mbikëqyrës i jashtëm, bashkëpunëtor ose dikush që nuk punon fare me viktimën (klient, shfrytëzues i shërbimeve, vizitor).
- Viktima mund të mos jetë personi që është shqetësuar, por mund të jetë kush do qoftë mbi të cilin ndikon sjellja e pakëndshme (pala e tretë e cila i duron pasojat nga atmosfera e krijuar e pakëndshme ose, personi persona të deprivilegjuar për shkak se persona tjerë e lejojnë ekzistimin e shqetësimit seksual).

Shqetësimi seksual ekziston pavarësisht nga ajo nëse ka dëm ekonomik për viktimën. Por, shqetësimi seksual reflektohet në kryerjen e obligimeve të punës së viktimës dhe/ose punëtorëve të tjerë.




Toleranca

■ Toleranca

Aftësi të pranohen dhe të respektohen bindjet dhe vlerat shoqërore të personave të tjerë ose grupeve të njerëzve. Zakonisht lidhen me sjellje fer, objektive dhe të hapur ndaj atyre që dallohen nga ne sipas mendimit, qëndrimeve, bindjeve, praktikave, religjioneve.

Në deklaratën për parimet e tolerancës së UNESCO, toleranca është definuar si: respektim, pranim dhe gëzimi në llojllojshmërinë e kulturave, mënyrave të shprehurit dhe mënyra të jesh njeri, të cilat ekzistojnë në botë. Toleranca paraqet harmoni në llojllojshmëri.

A large, bold, black uppercase letter 'U' is centered on the page. The letter is simple and sans-serif, with a consistent thickness throughout. It is positioned in the upper half of the page, leaving significant white space above and below it.

Udhëheqës i institucionit arsimor

Toleranca Afësi të pranohen dhe të respektohen bindjet dhe vlerat shoqërore të personave të tjerë ose grupeve të njerëzve. Zakonisht lidhen me shtyllë të hapur ndaj tyre që dallohen nga ne sipas mendimit, qëndrimeve, bindjeve, praktikave, ligjioneve, tolerancës së pranohen dhe të respektohen bindjet dhe vlerat shoqërore të personave të tjerë ose grupeve të njerëzve. Zakonisht lidhen me shtyllë të hapur ndaj tyre që dallohen nga ne sipas mendimit, qëndrimeve, bindjeve, praktikave, religjioneve, tolerancës së pranohen dhe të respektohen bindjet dhe vlerat shoqërore të personave të tjerë ose grupeve të njerëzve. Zakonisht lidhen me shtyllë të hapur ndaj tyre që dallohen nga ne sipas mendimit, qëndrimeve, bindjeve, praktikave, religjioneve, tolerancës së pranohen dhe të respektohen bindjet dhe vlerat shoqërore të personave të tjerë ose grupeve të njerëzve.

Fjalor i shprehjeve lidhur me diskriminimin

praktikë shoqërore të personave të tjerë ose grupeve të cilat lidhen me shtyllë të hapur ndaj tyre që dallohen nga ne sipas mendimit, qëndrimeve, bindjeve, praktikave, tolerancës së pranohen dhe të respektohen bindjet dhe vlerat shoqërore të personave të tjerë ose grupeve të njerëzve. Zakonisht lidhen me shtyllë të hapur ndaj tyre që dallohen nga ne sipas mendimit, qëndrimeve, bindjeve, praktikave, religjioneve, tolerancës së pranohen dhe të respektohen bindjet dhe vlerat shoqërore të personave të tjerë ose grupeve të njerëzve.



praktikë shoqërore të personave të tjerë ose grupeve të cilat lidhen me shtyllë të hapur ndaj tyre që dallohen nga ne sipas mendimit, qëndrimeve, bindjeve, praktikave, tolerancës së pranohen dhe të respektohen bindjet dhe vlerat shoqërore të personave të tjerë ose grupeve të njerëzve. Zakonisht lidhen me shtyllë të hapur ndaj tyre që dallohen nga ne sipas mendimit, qëndrimeve, bindjeve, praktikave, religjioneve, tolerancës së pranohen dhe të respektohen bindjet dhe vlerat shoqërore të personave të tjerë ose grupeve të njerëzve.

■ Udhëheqës i institucionit arsimor

Person ose organ i cili udhëheq me shkollën fillore, gjimnazin ose shkollën e mesme profesionale, konvikt ose institucion tjetër ku realizohet arsimimi ose trajnimi (drejtor dhe këshilli shkollor në arsimin fillor dhe të mesëm; rektor, prorektor, dekan dhe drejtor, në arsimin sipëror).



Veprimtaritë shërbyese juridike
Viktimizimi

■ Veprimtaritë shërbyese juridike

Shërbimet e avokatit (ku merr pjesë edhe ndihma juridike pa pagesë), forma të tjera të dhënies së ndihmës, këshilla juridike, këshillime dhe informata juridike, shërbimet e noterit, si dhe aktivitetet dhe shërbime (nga karakteri administrativ ose material-thelbësor) të lidhura me punën e Prokurorisë publike dhe gjykatave.

■ Viktimizimi

Sjellja e pavolitshme me person të caktuar (qoftë të jetë ai viktimë e diskriminimit ose jo) për shkakun se ndërmerr aktivitete të caktuara për mbrojtjen nga diskriminimi (pavarësisht nga ajo nëse diskriminimi është i drejtuar nga ai/ajo ose ndaj dikujt tjetër).

Për viktimizimin bëhet fjalë kur ekziston raport i pavolitshëm ndaj personit i cili: 113

- ka ndërmarrë, supozohet se ka ndërmarr ose do të ndërmarrë, aktivitete të cilat për qëllim kanë mbrojtjen nga diskriminimi (ka paraqitur diskriminim, ka njohur diskriminim, ka filluar procedurë legale për mbrojtjen nga diskriminimi)
- është në lidhje me personin që kanë ndërmarrë ose supozohet se ka ndërmarrë ose do të ndërmarrë aktivitete në drejtim të mbrojtjes nga diskriminimi (martesore, familjare, miqësie)
- ka refuzuar të diskriminojë ose ka penguar diskriminim

